



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Shkenca
Kompjuterike”**

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Thoma KORINI


Dr. Alketa GREPCKA

Maj / 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Bsc në "Shkenca Kompjuterike"

1	IAL aplikues:	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Kompjuterike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Shkenca Kompjuterike
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr 586, datë 07.07.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 439, datë 09.09.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	22 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	74 studentë (për një cikël të plotë studimi)
19	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM



Universiteti i Vlorës (UV) është një institucion publik i arsimit të lartë, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave N.105 dt.28.02.1944 (Emërtimi "Universiteti i Vlorës") dhe i riorganizuar me VKM Nr. 822, datë 05.12.2007 (Emërtimi "Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë"). UV i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 50, datë 27.11.2020, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.11.2025.

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ka 4 njësi kryesore: Fakultetin e Ekonomisë, Fakultetin e Shkencave Humane, Fakultetin e Shëndetit dhe Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore. Statuti i UV, në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 "PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" është miratuar me Vendim Senati Akademik të UV nr. 57, datë 06.09.2018 dhe Urdhër Nr.197, datë 1.04.2019 të MASR.

Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" është hapur me VKM kuotash Nr. 586, datë 07.07.2010. Forma e regjistrimit të diplomës është realizuar nëpërmjet Urdhërit të MASR Nr. 439, datë 09.09.2011 me emërtimin Bachelor në "Shkenca Kompjuterike". Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Shkencave Kompjuterike, njësi përbërëse e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore.

Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemin European të transferimit të krediteve në 180 kredite ECTS. Qëllimi i këtij programi studimesh është përgatitja e specialistëve me njohuri të qëndrueshme, të nevojshme për t'u bërë profesioniste të talentuar në disiplinat e shkencave kompjuterike. Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e UV.

UV ka aplikuar në ASCAL për akreditimin e programit të studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" më datë 20.05.2019, ndërsa dosja e dokumentacionit të akreditimit është transmetuar në 9 Mars 2020. Në këtë mënyrë, kemi të bëjmë me akreditimin e parë të këtij programi studimi.




PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në Mars 2020. Ky raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur UV për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër eviencash mbështetëse.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë” si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

GVJ gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga specialistja e ASCAL, Msc. Majlinda Demirneli. Takimet në institucion, parashikuar fillimisht në pranverën e vitit 2020, për shkak të pandemisë u zhvilluan on-line sipas programit të miratuar nga ASCAL. Takimet konsistuan në zhvillimin e diskutimeve nëpërmjet platformës *Cisco Webex*, me Zv.Dekanin e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, Përgjegjës të Departamentit të Shkencave Kompjuterike, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, përfaqësues të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Drejtorisë së Edukimit, përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë virtuale e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e sillabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 07.05.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 1/39 Prot, datë 07.05.2021. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë përcjell në ASCAL më datë 17.05.2021 me anë të shkresës me Nr. 815/2 Prot, datë 12.05.2021, “Përcjellje e komenteve



mbi Draft Raportin”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.


Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Shkenca kompjuterike”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca kompjuterike” u shërben interesave kombëtare duke përgatitur specialistë të cilët me kompetencat e tyre do t’i shërbejnë zhvillimit teknologjik në një fushë me zhvillim të shpejtë e me kontribut parësor në modernizimin e vendit.
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit, megjithëse nuk ka të bëjë direkt me fushën e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e kulturore kombëtare, mbështet zhvillimet prioritare të kohës në Shqipëri e më gjerë.
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Në Statutin e UV përcaktohet si mision formimi i specialistëve të lartë dhe përgatitja e shkencëtarëve të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit [Ev. Statuti i UV, Neni 3]. Në këtë kuadër programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” është përshtatur dhe ecën paralel me strategjinë për zhvillimin të UV duke synuar formimin dhe përgatitjen e studentëve premtues, profesionistë cilësorë në përshtatje me trendin e tregut të punës, shkencëtarë në shërbim të zhvillimeve dinamike jo vetëm në kontekstin kombëtar por edhe në atë europian e më gjerë, duke kaluar çdo barrierë të lidhur me prejardhjen e tyre sociale, ekonomike apo kulturore. [Ev. RVB, Takime në institucion].
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i propozuar i studimit favorizon një përgatitje teknike dhe bazë solide në të gjitha fushat e lidhura me shkencat kompjuterike. Referuar Planit Strategjik të zhvillimit të programit Bachelor në “Shkenca kompjuterike”, [Ev. Plani Strategjik i Programit] kërkohet që çdo i diplomuar të pajiset me konceptet teorike dhe praktikat të nevojshme në fushën e shkencave kompjuterike, i aftë të projektojë, zhvillojë dhe vlerësojë zgjidhjet bazuar në specifikat dhe kërkesat e fushës, të mirëmbajë, hartojë, ose zhvillojë projekte në fusha të ndryshme të shkencave kompjuterike, jo vetëm brenda vendit por edhe

	për tregun jashtë Shqipërise si dhe të garantohet forcimi i lidhjeve me tregun e punës, për të siguruar tek studentet informacion mbi tregun e punës, mundësitë konkrete të punësimit në tregun rajonal.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Referuar Planit Strategjik [Ev. Plani Strategjik i UV] dhe takimeve në institucion, GVJ është i mendimit se programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” është në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të UV duke qenë se një nga objektivat strategjike të UV është jo vetëm të ruajë traditën e tij, por njëkohësisht të zgjerojë dhe të zhvillojë degët tjera të kërkuara nga tregu siç janë Shkencat Kompjuterike.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Politika e zhvillimit të UV, e përcaktuar në statutin dhe strategjinë e zhvillimit, orientohen në krah të politikave kombëtare. Oferta didaktike e UV është e larmishme, ku programet e studimit synojnë të jenë programe gjithëpërfshirëse aktivitetesh, ku multidisiplinariteti është tipar i këtyre programeve për zhvillimin e aftësive të studentëve duke lehtësuar transferimin dhe formimin e mëtejshëm në programe të ngjajshme apo në programe të cikleve më të larta [Ev. Plani Strategjik i UV]. GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” është hartuar në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UV dhe zhvillohet duke u orientuar në përputhje me Planin Strategjik të Departamentit të Shkencave Kompjuterike dhe Planin Strategjik të zhvillimit të programit. [Ev. Plani Strategjik i Departamentit; Plani Strategjik i Programit të Studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”].
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Në Planin Strategjik të UV theksohet domosdoshmëria e hartimit dhe zbatimit të kurrikulave të përshtatshme, bazuar në sfidat e ekonomisë së tregut, jo vetëm kombëtar por edhe ndërkombëtar, për të pajisur dhe aftësuar studentët me njohuri që u lehtësojnë qasjen me tregun e punës kombëtar dhe rajonal/ndërkombëtar [Ev. Plani Strategjik i UV]. Në këtë aspekt, të gjitha programet ciklit të parë janë të organizuara me 180 kredite ECTS dhe japin akses në ofertën didaktike të ciklit të dytë të ofruar nga UV dhe IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit. Në mënyrë të veçantë programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” ofrohet në përputhje me objektivat strategjike të UV duke ju përgjigjur kërkesave të degëve të kërkuara nga tregu.



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe bisedimeve online, GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” ka për qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të transmetojë të të diplomuarit njohuri të qendrueshme, të nevojshme për t’u bërë profesionistë të talentuar në disiplinat e shkencave kompjuterike si administrim i rrjetave kompjuterike, projektim dhe zhvillim i aplikacioneve desktop apo mobile, programim desktop apo web, si dhe në fusha të tjera të ekonomisë dhe shoqërisë, të cilat lidhen me teknologjinë e informacionit; - përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor, për t’i aftësuar për studimet master ishkenca në shkenca kompjuterike, apo në fusha të tjera me të cilat programi lidhet; - zhvillimin e kapaciteteve për shfrytëzimin e njohurive dhe aftësive në shkencat kompjuterike në menyrë efektive për përmirësimin e shoqërisë, nëpërmjet përfshirjes së studentëve në projekte që synojnë shërbime për shoqërinë, komunitetin apo organizata të ndryshme; - ndërgjegjësimin për nevojën e të mësuarit gjatë gjithë jetës; - përfitimin nga eksperiencia e departamenteve analoge në universitetet brenda dhe jashtë vendit. <p>[Ev. Plani Strategjik i programit, Takime në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe</p>	<p>GVJ është i mendimit se, megjithëse nuk ka ndonjë studim të detajuar tregu, institucioni, për të mbështetur formimin e studentëve në fushën e shkencave kompjuterike, bazohet në zhvillimet e shpejta në këtë fushë në dekadat e fundit, prioritetet kombëtare në këtë drejtim si dhe kërkesat nga bizneset dhe institucionet e qytetit të Vlorës. [Ev. Takime në institucion].</p> <p>UV synon që nëpërmjet Qendrës Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillimin Rajonal të forcojë lidhjet me tregun e punës si dhe nëpërmjet Sektorit të Këshillimit të Karrieres dhe ALUMNI të gjurmojë studentët e diplomuar në UV gjatë karrierës profesionale</p>

zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	të tyre. Nga bisedat e zhvilluara, GVJ konstatoi se ka të dhëna për gjurmimin e studentëve të diplomuar. [Ev. Takime me Drejtorinë e edukimit]			
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Në përfundim të studimeve studentët e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” synohet të punësohen si [Ev. Plani Strategjik i programit]: <ul style="list-style-type: none">- Mirëmbajtës dhe administratorë të rrjeteve, bazave të të dhënave, ose sistemeve kompjuterike;- Specialistë të teknologjisë së informacionit në organizata, institucione apo kompani biznesi;- Specialistë në sigurinë e sistemeve kompjuterike, si dhe të të dhënave;- Programues dhe zhvillues aplikacionesh;			
	Nga analiza e strukturës së programit të studimit, GVJ konstatoi se ai është hartuar në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Gjithashtu, përsa i përket përmbajtjes, në këtë program studimi janë pasqyruar elementët e nevojshëm formues të cilët garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës, lehtësojnë punësimin e studentëve, mundësojnë transferimin e studimeve në fusha të ngjajshme si brenda institucionit, ashtu edhe në institucione të tjerë që ofrojnë programe të ngjajshme studimi si dhe, pas diplomimit, mundësojnë vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X


Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” ofrohet nga DSHK pjesë e FSHT. Misioni i DSHK është të arrijë përsosmërinë në krijimin dhe transmetimin e njohurive në Shkenca



<p>për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Kompjuterike për të nxitur zhvillimin intelektual dhe profesional të studentëve duke iu përgjigjur nevojave të shoqërisë, nëpërmjet zgjerimit dhe diversifikimit të fushave që departamenti ofron [Ev. Strategjia e DSHK].</p> <p>Plotësimi i këtij misioni mbështetet në një staf total prej 18 punonjësish [Ev. Të dhëna mbi personelin e DSHK], nga të cilët 13 janë PAE, 3 PAK dhe 2 personel ndihmës akademik. Përsa i përket PAE, 5 prej tyre janë me gradën shkencore “Doktor”, 3 janë në proces të përgatitjes së doktoratës, ndërsa 5 janë me diplomën Master i Shkencave.</p> <p>Referuar [Ev. Të dhënat e stafit akademik për vitin 2020-2021, të dhënat për numrin e studenteve për të tre programet e studimit.PDF], FSHT ka në përbërje të tij për vitin akademik 2020-2021, 86 pedagogë gjithsej nga ku 66 pedagogë si Personel akademik efektiv (PAE), dhe 20 pedagogë si personel akademik me kontratë (PAK).</p> <p>Referuar fushës individuale të kualifikimit, GVJ konstatoi se personeli i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” disponon formimin e duhur për të garantuar një mësimdhënie cilësore. Një garanci suplementare për një qëndrueshmëri dhe rritje të nivelit cilësor jo vetëm të mësimdhënies, por edhe të kërkimit shkencor do të përbënte rritja e shkallës së kualifikimit të PAE.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Duke ju referuar strukturës së FSHT dhe programeve të ofruara të studimeve, konstatohet se ky fakultet ka në përbërjen e tij 6 njësi bazë, të cilat garantojnë formimin në diploma që lidhen me shkencat teknike dhe natyrore. Në këtë mënyrë GVJ konstatoi se ka një përputhje ndërmjet fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushës akademike e kërkimore të FSHT. Duke ju referuar kërkesave të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” përsa i përket kodifikimit të programeve të studimit, në kushtet kur mungojnë aktet nënligjore, institucioni ka aplikuar kodifikimin e brendshëm të lëndëve të programit të studimit dhe është kujdesur që, në përputhje me kërkesat ligjore, programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” të ketë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind me programe analoge të Universitetit të Tiranës.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e</p>	<p>DSHK, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”, është pjesë e FSHT dhe ka për mision të arrijë përsosmërinë në krijimin dhe transmetimin e njohurive në Shkenca Kompjuterike për të nxitur zhvillimin intelektual dhe profesional të studentëve duke iu përgjigjur nevojave të shoqërisë, nëpërmjet</p>



studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	zgjerimit dhe diversifikimit të fushave që ofron. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimeve online, GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të DSHK. <i>[Ev. Strategjia e DSHK, Takime në institucion].</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Hartimi, mbikëqyrja dhe mbarëvajtja e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” mbulohet nga DSHK. Për të mundësuar formimin e studentëve me njohuritë e kërkuara për këtë program të ciklit të parë, DSHK bashkëpunon edhe me departamente të tjerë të FSHT si dhe më gjerë në nivel institucioni duke përcaktuar qartë si nivelin e angazhimit ashtu edhe detyrimet reciproke. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe marrëveshjet për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik <i>[Ev. Marrëveshje mbi planifikimin vjetor të punës]</i>, ku përcaktohet jo vetëm ngarkesa mësimore në auditor e detajuar sipas elementëve formues dhe veprimtaria jashtë auditorit në mbështetje të procesit mësimor, por edhe gjithë kontributi i PA në elementë të ndryshëm të aktivitetit të departamentit. Këto marrëveshje shërbejnë si bazë për organizimin e analizave vjetore <i>[Ev. Raport i përgjegjësit të grupit mësimor]</i>, të cilat i shërbejnë përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies duke përcaktuar edhe detyra për të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të DVV, GVJ konstatoi se UV ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të biznesit <i>[Ev. Marrëveshje dhe projekte të UV]</i>. Këta elementë konfirmohen edhe nga takimet online me institucionin. Marrëveshjet me institucione homologe jashtë vendit i kanë shërbyer kryesisht mobilitetit si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve. Përsa u përket marrëveshjeve me biznesin, deri më tani i kanë shërbyer kryesisht marrjes së informacionit mbi kërkesat e tyre si dhe parashtrimin të ofertave të punësimit. <i>[Ev. Takime në institucion].</i></p>

<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësjia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga diskutimi me pedagogë dhe drejtuesin e DSHK, GVJ u informua se marrëveshjet e bashkëpunimit kanë kontribuar në fitimin e eksperiencës në mësimdhënie nga ana e personelit akademik si dhe inicimin e projekteve të cilët përfshijnë aspekte të ndryshme të jetës universitare. [Ev. Takime në institucion].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Referuar planit mësimor, programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”, nuk ka të parashikuar komponentin e praktikës mësimore. Ana praktike lidhur me këtë program studimi realizohet nëpërmjet seanceve të laboratorit dhe nëpërmjet punës individuale apo në grup nën drejtimin e pedagogut konkretizuar në trajtën e detyrave të kursit apo projekteve [Ev. Plani mësimor, Takime në institucion]. Megjithatë, nga bisedimet me pedagogët dhe studentët u shtrua nevoja për integrimin e praktikës mësimore si një aktivitet i nevojshëm jo vetëm në kuadër të formimit në fushën e shkencave kompjuterike, por edhe si një mundësi për të krijuar lidhje me biznesin të cilat do të kontribonin në punësimin e ardhshëm të studentit të diplomuar. [Ev. Takime në institucion].</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Në UV është parashikuar funksionimi i zyrës Life Long Learning e integruar në Qendrën e Zhvillimit Rajonal (RDC), të cilës i atribuohet zhvillimi i misionit të tretë të universitetit, përfshirë identifikimin dhe analizën e nevojave për edukimin e vazhdueshëm gjatë gjithë jetës, si dhe organizimin e programeve të shkurtra të studimit për zhvillimin e kompetencave të reja profesionale, në ndihmë të studentëve, stafit dhe komunitetit në rajon [Ev. Plani Strategjik i UV]. RDC ka synimin të kthehet në një qendër të kërkimit dhe edukimit të vazhdueshëm për të mbështetur të mësuarit gjatë gjithë jetës. GVJ konstatoi se në rang institucioni janë organizuar trajnime për shkrim projektesh si dhe trajnimet për mësues (inicuar në kuadër projekti). [Ev. Raporti i RDC, Takime në institucion]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Referuar planit mësimor, GVJ konstati se programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Forma e studimit për këtë program është me kohë të plotë dhe realizohet për 3 vite akademike me nga 2 semestra secili. Përfundimit të këtij programi studimesh i korresponon grumbullimi i 180 krediteve ECTS, duke realizuar çdo vit 60 kredite.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” i korresponon Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve duke fituar njohuritë, afësitë dhe kompetencat në [Ev. <i>Plani Strategjik i Programit</i>]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Administrim të rrjeteve kompjuterike, projektim dhe zhvillim i aplikacioneve desktop apo mobile, programim desktop apo web, si dhe në fusha të tjera të ekonomisë dhe shoqërisë, të cilat lidhen me teknologjinë e informacionit; - Aftësinë për të projektuar, zhvilluar dhe vlerësuar zgjidhjet bazuar në specifikat dhe kërkesat e fushës, të mirëmbajtje, hartojë, ose zhvillojë projekte në fusha të ndryshme të shkencave kompjuterike; - Përvehtësimin e njohurive të moduleve specifike, të natyrës teorike ose praktike lidhur me tendencat e reja të disiplinave të shkencave kompjuterike. <p>Njohuritë e përftuara në këtë cikël studimi krijojnë një bazë dhe shprehi të mjaftueshme për të avancuar në një shumëllojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh të lidhura me shkencat kompjuterike.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” është hartuar në mënyrë të tillë që të përmbajë elementët teorikë bazë të nevojshëm për të mundur thellimin në drejtime më specifike që lidhen me shkencat kompjuterike. Për të garantuar këtë aspekt synohet në mënyrë të vazhdueshme të përmirësohet programi i studimit për të pasqyruar zhvillimet dinamike në këtë fushë. GVJ konstatoi një përkushtim të stafit akademik në përmirësimin dhe</p>



	<p>përshtatjen e syllabuseve të lëndëve me këto zhvillime [Ev. Takime në institucion].</p> <p>Nga ana tjetër GVJ konstatoi se plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”, në versionin aktual të tij, paraqitet me specifika të pasqyruara vetëm në rreth 10% ndryshim në raport me programin e studimit Bachelor në “Informatikë” (ndryshim praktikisht i pasqyruar vetëm në vitin e tretë). Kjo problematikë është adresuar nga ana e DSHK nëpërmjet propozimeve për përmirësim të programit, paraqitur në MASR, por për të cilat nuk ka akoma një përgjigje. Në këtë mënyrë, DSHK ka parashikuar të riaplikojë në MASR me qëllim që këto propozime të bëhen efektive.</p> <p>[Ev. Takime në institucion, Praktikë e dorëzuar në MASR për riorganizimin e programeve të studimit Bsc në Shkenca Kompjuterike].</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Aftësitë dhe kompetencat e avancuara të përftuara në kuadër të këtij programi studimi mundësojnë nga njera anë një ekspertizë të thelluar në problematika të tilla si programues kompjuteri, inxhinieri softueri, zhvillues web, teknik rrjetesh kompjuterike në institucione private apo shtetërore dhe nga ana tjetër krijojnë një bazë të shëndoshë për të thelluar studimet në ciklin e dytë të tyre, Master i Shkencave apo Master Profesional.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ konstatoi se hartimi i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” është bërë duke u mbështetur në të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë, është hartuar duke respektuar kërkesat e VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe Procedura e hartimit dhe miratimit të tyre ka kaluar në gjitha hallkat e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga analiza e programit të studimit [Ev. Plani mësimor i programit], GVJ konstatoi se janë përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët sipas kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore. Duke i ballafaquar dhe përshtatur në përputhje me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” veprimtaritë formuese të programit mund të grupohen:</p> <p>A. LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (40 kredite)</p>

	<p>B. LËNDË KARAKTERIZUESE –përgatitje për disiplinën shkencore (90 kredite)</p> <p>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhegrup-lëndë me zgjedhje (30 kredite)</p> <p>D. LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike,praktika profesionale (14 kredite)</p> <p>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE (6 kredite)</p> <p>si dhe respektohet kërkesa që përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B të mos jetë më pak se 70%, në rastin e programeve të ciklit të parë Bachelor.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	UV është akredituar institucionalisht me Vendim BA Nr. 50, datë 27.11.2020, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.11.2025. Njësitë kryesore të UV dhe në veçanti FSHT përmbush detyrimet ligjore në lidhje me numrin e njësive bazë. Referuar personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në të, GVJ konsatoi se njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, DSHK përmbush kriteret ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	DSHK është i organizuar në Grupe Mësimore Kërkimore: <ul style="list-style-type: none"> - Grupi mësimor kërkimor “Sisteme Kompjuterike”; - Grupi mësimor kërkimor “Projektim dhe zhvillim softueri”. <p>GVJ konstatoi se nuk ka një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, por kjo detyrë mbulohet nga përgjegjësit e grupeve mësimore kërkimore të cilët ndjekin ecurinë dhe zhvillimin e programit sipas grup-lëndëve respektive që mbulojnë dhe raportojnë në mënyrë periodike në DSHK për elementë që lidhen me programin e studimit.</p> <p>[Ev. Raporte të aktivitetit të grupeve mësimore].</p>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për	Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstatoi se FSHTN si njësi kryesore e UV dhe DSHK si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” përmbushin detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

organizimin dhe strukturën akademike.	Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor i Asociuar” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “Doktor i Shkencave”.			
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	<p>DSHK plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 25 të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>DSHK ka në përbërjen e tij një staf total prej 18 punonjësish, nga të cilët 13 janë PAE, 3 PAK dhe 2 personel ndihmës akademik. Përsa i përket PAE, 5 prej tyre janë me gradën shkencore “Doktor”, 3 janë në proces të përgatitjes së doktoratës, ndërsa 5 janë me diplomën Master i Shkencave [Ev. Të dhënat e stafit akademik 2020-2021]. GVJ konstatoi se ka një qëndrueshmëri të stafit akademik në vitet e fundit.</p> <p>Megjithëse kriteret minimale ligjore plotësohen, <i>GVJ sygjeron që të ndërmerren hapa për përmirësimin e shkallës së kualifikimit të personelit akademik efektiv, gjë e cila do të kontribonte për ngritjen në një shkallë më të lartë edhe të kërkimit shkencor.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” paraqitet i detajuar në të gjithë elementët e tij që përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Planin mësimor; - Rregullorja e programit të studimeve; - Suplementi i diplomës Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”; - Programet (syllabuset) e lëndëve; - Modeli i diplomës; - Plani strategjik i Programit të Studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”



	<p>Ky informacion i shoqëruar me kuotat dhe kriteret e përvitshme të pranimit përbëjnë informacionin bazë të programit të studimit, i cili disponohet nga DSHK dhe pjesërisht vihet në dispozicion të studentëve të ciklit Bachelor dhe të kandidatëve për studentë nga shkollat e mesme.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga analiza e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” rezulton se ai është i organizuar në lëndë e aktivitete formuese në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p><u>GVJ konstatoi mungesën e praktikës profesionale si aktivitet formues, gjë e cila ka tërhequr vëmendje edhe të DSHK dhe është pasqyruar në propozimin e paraqitur për riorganizimin e programit të studimit që në vitin 2018. Propozimi, ndërmjet të tjerave, konsistonte në integrimin e praktikës profesionale me një vëllim prej 6 kreditesh ECTS. Duhet theksuar nga ana e MASR nuk i është dhënë përgjigje kërkesës për riorganizimin e propozuar.</u></p> <p>[Ev. Praktikë e dorëzuar në MASR për riorganizimin e programeve të studimit Bsc në Shkenca Kompjuterike]</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” është i organizuar sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Forma e studimit për këtë program është me kohë të plotë dhe realizohet për 3 vite akademike me nga 2 semestra mësimdhënie secili. Përfundimit të këtij programi studimesh i korrespondon grumbullimi i 180 krediteve ECTS, duke realizuar çdo vit 60 kredite (30 kredite për semestër).</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor si elementi bazë i programit të studimit përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndarjen e lëndëve sipas aktiviteteve formuese; - Ndarjen e lëndëve sipas viteve dhe semestrave; - Dhënie për secilën lëndë të ngarkesës në kredite, numrit total të orëve, numrit të orëve në auditor dhe jashtë auditorit; - Ndarjen e ngarkesës në auditor për secilën lëndë në elementët përbërës si leksione, seminare e laboratorë. <p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen edhe elementë që lidhen me shkallën e detyrueshme të frekuentimit, mënyrën e shlyerjes së lëndëve, përmirësimin e notave, mënyrën e diplomimit etj. GVJ është i mendimit se eventualisht mund të specifikoheshin edhe elementë që lidhen me ngarkesën në auditor të detyrave apo projekteve të kursit.</p> <p>[Ev. Rregullorja e programit të studimit].</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme</p>	<p>Të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve jepen në Rregulloren e programit të</p>

dhe specifikë të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” dhe në Rregulloren e UV. GVJ është i mendimit se praktikat e prezantuara për transferim studimesh dhe program të dytë studimesh dëshmojnë për procedura të qarta dhe transparente të zbatuara nga institucioni. [Ev. Procedurë transferimi e studentëve]			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Elementë më të detajuar për lektorin apo lektorët që do të zhvillojnë lëndën, semestrin kur zhvillohet, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti, objektivat, elementët e mësimdhënies, detyrimet për frekuentimin, literaturën, mënyrën e shlyerjes së lëndës dhe peshën e elementëve të ndryshëm në vlerësimin final jepen në syllabuset e lëndëve [Ev. Syllabuset e lëndëve]. GVJ konstatoi se syllabuset e lëndëve përmbajnë gjithë elementët e nevojshëm përcaktuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Referuar RVB dhe dokumentacionit në dispozicion, programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” i është nënshtruar riorganizimit në vitin 2012-2013 me qëllim përmirësimin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e kohës, nevojat e tregut të punës si dhe për të freskuar programet lëndore më literaturë dhe botime bashkëkohore. Një tjetër ndryshim i kufizuar është bërë në vitin akademik 2016-2017 [Ev. RVB]. Ndryshimi më thelbësor riorganizimin e programit të studimit është propozuar në vitin 2018, propozim të cilit nga ana e MASR nuk i është dhënë përgjigje [Ev. Praktikë e dorëzuar në MASR për riorganizimin e programeve të studimit Bsc në Shkenca Kompjuterike]. Propozimeve të kryera u paraprijnë analiza të ecurisë së programit të studimit [Ev. Analizat vjetore në DSHK, Raport i përgjegjësimit të grupit mësimor]. GVJ është i mendimit se ky riorganizim i programit të studimit është i domosdoshëm dhe do t’i shërbente përmirësimit të formimit në këtë program dhe një dallimi të qartë nga programi i studimit Bachelor në “Informatikë”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstatoi se ngarkesa mësimore është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Ngarkesa është përcaktuar në bazë të sistemit të krediteve ECTS, duke parashikuar 30 kredite në semestër. Nga totali prej 4500 orësh mësimore për të tre vitet e studimit, 1830 prej tyre (rreth 41%) janë parashikuar në auditor. Në këtë mënyrë, duke ju referuar të tre viteve akademike, rezultojnë që ngarkesa javore në auditor të luhatet në intervalin 20 deri 23 orë (me përjashtim të semestrit të fundit që i korrespondon dhe diplomimit, ku kjo ngarkesë parashikohet më e ulët) [Ev. Plani mësimor]</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe takimeve online, GVJ është i mendimit se përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve mundësojnë, njohuri, aftësi dhe kompetenca të cilat garantojnë formimin e nevojshëm për punësim të studentëve. Eventualisht (gjë që është parashikuar edhe në rishikimin e programit të studimit të vitit 2018), praktika profesionale do të zhvillonte jo vetëm kompetenca që lidhen me tregun e punës, por do të ndihmonte për një integrim më të lehtë në të.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Nga vlerësimi i planit mësimor [Ev. Plani mësimor], GVJ konstatoi se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional në fushën e shkencave kompjuterike. <u>Eventualisht, mund të kishte një detajim duke integruar në planin mësimor edhe elementë të tillë si detyrat apo projektet. Gjithashtu, bazuar edhe në mendimet e studentëve, do të ishte më efekt pozitiv në formimin në fushën e shkencave kompjuterike rritja e peshës së seancave laboratorike.</u> [Ev. Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ është i mendimit se në përgjithësi struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Eventualisht mund të rritet pesha e seancave laboratorike dhe integrimi në program i praktikës mësimore. DSHK ka patur si objektiv që ky program studimi të ketë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind me programe analoge të Universitetit të Tiranës.</p> <p><u>Gjithashtu, GVJ është i mendimit se programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” i ofruar nga DSHK është shumë i përafërt</u></p>



	<p>me programin e studimit Bachelor në “Informatikë” të ofruar nga i njejt Department. Ky ndryshim në versionin aktual të programeve është i rendit 10% duke mos ofruar një dallim të qartë ndërmjet këtyre 2 programeve. Kjo problematikë është adresuar nga ana e DSHK nëpërmjet propozimeve për përmirësim të programit, paraqitur në MASR, por për të cilat nuk ka akoma një përgjigje. Në këtë mënyrë, DSHK ka parashikuar të riaplikojë në MASR me qëllim që këto propozime të bëhen efektive.</p> <p>[Ev. Takime në institucion, Praktikë e dorëzuar në MASR për riorganizimin e programeve të studimit Bsc në Shkenca Kompjuterike].</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ është i mendimit se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Personeli akademik si dhe studentë të cilët kanë përfituar mobilitete në institucione analoge jashtë vendit në programe të ngajshme kanë konstatuar një përputhje të mirë të këtij programi studimi me programe analoge.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Përditësimi në mënyrë të vazhdueshme i lëndëve duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të viteve të fundit paraprihet nga analiza të ecurisë së programit të studimit [Ev. Analizat vjetore në DSHK, Raport i përgjegjës të grupit mësimor]. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të këtij programi studimi GVJ konstatoi se, përjashtuar disiplinat bazë ku ndryshimet janë më të kufizuara, ato përgjithësisht janë të përditësuara me literaturë bashkëkohore (të 5 deri 10 viteve të fundit). Në rastin e programit të studimit në fushën e shkencave kompjuterike, kjo vjen edhe si domosdoshmëri për arsye të zhvillimeve të shpejta në këtë fushë. Ndryshimet në literaturë miratohen në mbledhje të Departamentit dhe pasqyrohen në programin e lëndës. [Ev. RVB, Literatura e miratuar në Departament].</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”, i vlerësuar në përmbajtje nga GVJ, garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për një program studimi të ciklit të parë. Nga takimet me studentët rezultojn se realizimi faktik i programit të studimit është brenda pritshmërive të tyre [Ev. Takim me studentët].</p> <p><u>GVJ rekomandon se rritja e kontributit të seancave laboratorike dhe integrimi në program i praktikës mësimore do të përmirësonte formimin në këtë program.</u></p> <p>Nga një analizë e detajuar e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”, në versionin aktual të tij, rezultojnë lëndët:</p>



LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore	Ssitemet elektronike dhe rrjetat logjike
	Programim në C++
	Programim në Java
	Struktura të dhënash dhe algoritmikë
	Sisteme operative
	Programim në Web
	Hyrje në rrjetat kompjuterike
	Projektimi dhe analiza e algoritmave
	Hyrje në inteligjencën artificiale
	Baza të dhënash
	Arkitekturë kompjuteri
LËNDË INTERDISILINORE -INTEGRUESE	Kompilatorët
	Probabilitet dhe Statistikë
	Animacione kompjuterike
	Teknologjia dhe multimedia interaktive
	Siguria e sistemeve kompjuterike
	Programim konkurrent

GVJ konstaton se kemi të bëjmë me lëndë të cilat formojnë bërthamën në përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave për këtë program studimi. Nga ana tjetër, duke patur parasysh zhvillimet e shpejta në këtë fushë, janë të nevojshme jo vetëm përditësimet e syllabuseve, por edhe ristrukturime të herëpashershme të programit të studimit. Propozimi i DSHK për riorganizimin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” synon përshtatjen me realitetin e ri dinamik në këtë fushë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit plotësues [Ev. Praktikë e dorëzuar në MASR për riorganizimin e programeve të studimit Bsc në Shkenca Kompjuterike], GVJ konstatoi se janë me rëndësi përmirësimet e propozuara të cilat mund të përmbliidhen në sa vijon:

A) Riorganizim lëndësh

- Hyrje në programim dhe Struktura të dhënash në C
- Elektronikë, Sisteme elektronike dhe Rrjeta logjike
- Kalkulus
- Fizikë
- Programim i orientuar nga objektet
- Arkitekturë kompjuteri dhe rrjeta kompjuterike
- Baza të dhënash dhe menaxhim të dhënash nën Oracle
- Kompilatorët dhe interpretuesit

B) Lëndë të reja

- Hyrje në shkencat kompjuterike
- Matematikë diskrete
- Programim mobile
- Cloud computing
- Machine learning

	- Praktikë profesionale			
	Në këtë aspekt, GVJ e gjen me vend propozimin e DSHK dhe rekomandon riaktivizimin sa më të shpejtë të procedurave për të mundësuar zbatimin praktik të programit të riorganizuar.			
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Referuar DVV dhe takimeve në institucion, GVJ është i mendimit se përmbajtja e programit të studimit garanton si punësimin direkt mbas diplomimit ashtu edhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë. Një pjesë e mirë e studentëve të diplomuar në këtë program studimi vazhdojnë studimet Master Profesional në Mësuesi ose Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike, ndërsa një pjesë vazhdojnë studimet e ciklit të dytë në IAL të tjera. [Ev. RVB, Takime në institucion]			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	GVJ konstatoi se institucioni në përgjithësi si dhe FSHTN dhe DSHK në veçanti, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm nga tregu i punës si dhe nëpërmjet projekteve që lidhen me punësimin apo aktivitete të organizuara nga Sektori i Këshillimit të Karrierës në lidhje me studentët dhe tregun e punës, kanë synuar nga njera anë përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit me kërkesat e tregut e punës dhe nga ana tjetër ofrimin dhe njohjen e studentëve me këtë treg. [Ev. Marrëveshje bashkëpunimi, Aktivitete për njohjen me tregun e punës].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës, kriter i cili plotësohet nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi [Ev. Të dhënat e stafit akademik].						
	PAE			PAK			
	Viti	Lektor (Prof.As.)	Lektor (Dr.)	As.Lektor (MSc)	Lektor (Prof.As.)	Lektor (Dr.)	As.Lektor (MSc)

2020-2021	2	10	10	-	1	-
2019-2020	1	12	11	-	1	-
2018-2019	1	7	11	-	-	-
2017-2018	1	9	13	-	-	-
2016-2017	1	4	15	-	-	-

Mbulimi i programit në përqindje sipas viteve akademike është:

Për vitin akademik 2020-2021 **97% PAE dhe 3% PAK.**

Për vitin akademik 2019-2020 **96% PAE dhe 4% PAK.**

Për vitin akademik 2018-2019 **100% PAE**

Për vitin akademik 2017-2018 **100%.**

Për vitin akademik 2016-2017 **100%.**


Referuar tabelës përmbledhëse, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është personel akademik me kohë të plotë.

GVJ e vlerëson si pozitiv faktin që referuar ecurisë në vite, personeli akademik As.Lektor është zvogëluar në favor të personelit akademik të kategorisë Lektor. Megjithatë do të duhej që kjo tendencë të konfirmohej edhe në të ardhmen duke qenë se personeli akademik i kategorisë As.Lektor është i angazhuar me kontratë me afat të kufizuar (një-vjeçare, të rinovueshme).

Nga analiza e ngarkesës së mësimore të personelit akademik, GVJ konstatoi se ngarkesa në orë mësimore në auditor është relativisht e lartë. Në një numër rastesh kjo ngarkesë kalon kufirin e normës mësimore plus një mbingarkesë prej 200 orësh suplementare në auditor (përcaktuar në Udhëzimin Nr.29, datë 10.9.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë". GVJ është i mendimit se një ngarkesë mësimore e tillë vështirëson angazhimin e personelit akademik në kërkimin shkencor.

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin

Nga analiza e të dhënave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, GVJ konstatoi se ky personel ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor. Megjithatë, GVJ është i mendimit se ngritja e personelit akademik të kategorisë As.Lektor në rangun e Titullarit të lëndës, përbën një avancim i cili mund të mbetet i justifikuar për një




dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<u>periudhë të shkurtër kohore deri në përmirësimin e raporteve ndërmjet kategorive Lektor dhe As.Lektor.</u>			
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Nga shqyrtimi CV të stafit akademik, GVJ konstatoi se fushat e interesit dhe kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me modulet/lëndët që mbulojnë [Ev. CV të stafit akademik]. Nga takimet në institucion GVJ u informua se një pjesë e personelit akademik të kategorisë As.Lektor ishte i angazhuar në përfundimin e studimeve të doktoratës [Ev. Takime në institucion]. Një element pozitiv i konstatuar është dhe qëndrueshmëria e stafit akademik në vite.			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UV ka nënshkruar një numër marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani [Ev. Marrëveshje dhe projekte të UV, Marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Vlorë]. Këto marrëveshje kanë shërbyer kryesisht për mobilitetin si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve, ndërsa nuk është përfituar për realizimin e praktikave profesionale duke qenë se ato nuk janë pjesë e versionit aktual të programit të studimit. Në rishikimin e programit të studimit të vitit 2018 është parashikuar edhe praktika profesionale e cila jo vetëm do të zhvillonte kompetenca që lidhen me tregun e punës dhe do të ndihmonte për një integrim më të lehtë në të, por do të rriste shkallën e përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Personeli ndihmës akademik i DSHK është i angazhuar kryesisht për mbulimin e seancave praktike laboratorike të lëndëve të përfshira në programin e studimit. Në mënyra të veçantë garantohet mirëmbajtja e bazës materiale kompjuterike si dhe instalimi i software-ve, menaxhimi i llogarive të studentëve në serverat e laboratorëve etj. si dhe asistohen studentët gjatë zhvillimit të seancave laboratorike [Ev. RVB, Takime në intitucion].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>UV ka miratuar udhëzuesin mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit [Ev. <i>Udhëzues për zhvillimin e metodave të mësimdhënies</i>]. Objektivi kryesor i këtij Udhëzuesi ka të bëjë me shqyrtimin, diskutimin dhe transferimin e praktikave më të mira inovative në mësimdhënien për IAL, duke nxitur përdorimin e tyre në to. Si objektiva specifike përcaktohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shkëmbehen dhe të implementohen ide dhe përvoja rreth kalimit në mësimdhënie me “Studentin në qendër”; • Të udhëzohet se si strukturat dhe mjetet mund të mbështesin inovacionin në mësimdhënie në perputhje me tendencat evropiane; • T’i kushtohet një vëmendje më e madhe plotësimit të kërkesave të Bolonjës në dritën e detyrimeve të Ligjit të Arsimit të Lartë; • Të inkurajohet bashkëpunimi në nivele vertikale dhe horizontale në UV për përmirësimin e shërbimit të mësimdhënies; • Të nxitet bashkëpunimi edhe në nivel rajonal për inovacionin në mësimdhënie; • Të nxitet diskutimi për rishikimin dhe projektimin e kurrikulave të programeve që përgatisin mësues; • Të nxitet dhe inkurajohet përdorim më i madh i TIK në procesin mësimor dhe në atë e-learning; • Të nxitet diskutimi për futjen e përdorimit të platformave si MOODLE, etj;
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>UV ka hartuar një strategji për trajnimin e vazhdueshëm të kërkuesve të rinj. Synimet strategjike bazohen në komponentët trajnues të stafit/kërkuesve të rinj si fillimi i karrierës akademike, mentorimi, trajnime në edukim të vazhduar, trajnime për të përmirësuar aftësitë e buta (soft skills), trajnime për shkrim projektsh kërkimore, forcimi i network-ut akademik, informimi i vazhduar rreth fondeve kërkimore, mobiliteteve dhe mundësive të tjera të financimit për kërkuesit e rinj si dhe multidisiplinarteti në kërkim [Ev. <i>Strategjia për Trajnimin e vazhdueshëm të Kërkuesve të Rinj</i>].</p> <p>Gjithashtu NJSBCVI ka si funksion kryesor bashkëpunimin për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies. Ndër instrumentat e përdorur</p>




	nga kjo njësi dallohet pyetsori i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve për çdo program studimi. GVJ u njoh me etapat nëpër të cilat kalon ky vlerësim i cilësisë deri në hartimin e raportit i cili shoqërohet me hartimin e një plani masash dhe me ndjekjen e zbatueshmërisë së tij. [Ev. Raporte mbi rezultatet e pyetesorit studentor, Takime në institucion].			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	GVJ konstatoi se garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetesorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve për çdo program studimi i cili plotësohet në fund të çdo semestri. Ky pyetsor plotësohet në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit të informacionit të UV [Ev. Takime në institucion] Përsa i përket trajtimit të ankimimeve të studentëve, kjo e drejtë sanksionohet në Rregulloren e programit të studimit dhe në Rregulloren e DSHK. GVJ u njoh me një procedurë ankimimi të studentëve dhe mënyrën e trajtimit të saj dhe e gjeti atë të plotë dhe transparente [Ev. Procedurë ankimimi në departament].			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ u informua mbi publikimin në mënyrë periodike nga ana e NJSBCVI të raporteve të analizës së pyetesoreve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke i vënë kështu në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara. [Ev. https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/]			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	GVJ konstatoi se një rol të madh në promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies luan Grupi Mësimor Kërkimor në nivel njësie bazë. Nga analizat e kryera në fund të semestrit, GVJ vëren se ka shembuj të diskutimit të praktikave të ndjekura nga personeli akademik për metodologjinë e mësimdhënies duke analizuar përparësitë e metodave të ndjekura nga secili dhe duke konkluduar për metodën më të mirë si dhe rrugët për implementimin më efikas të saj. [Ev. Raport aktiviteti grupi mësimor].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Baza e realizimit të procesit mësimor në auditor është ora mësimore. Një orë mësimore e ka kohëzgjatjen 60 minuta. Ndër format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë leksionet, seminarët, laboratorët dhe detyrat e kursit. GVJ konstatoi se format klasike të mësimdhënies ndërthuren me metoda të ndryshme bashkëkohore. Nga diskutimi me pedagogët dhe studentët e programit, GVJ u informua për mënyrën e zhvillimit të lëndëve të ndryshme dhe në mënyrë të veçantë për peshën e elementëve formues të parashikuar në secilën lëndë. U konstatua se personeli akademik i kushton një rëndësi të veçantë realizimit të detyrave apo projekteve të kursit. Gjithashtu aplikohen forma të punës në grup për realizimin e një detyre apo projekti, duke zhvilluar në këtë mënyrë edhe elementë të tillë si menaxhimi i ndarjes së punës, integrimi pjesëve individuale në një të tërë, referimi i materialit përfundimtar nga grupi etj. [Ev. Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Për t'ju përgjigjur diversitetit dhe kërkesave të studentëve, personeli akademik mban kontakt të vazhdueshëm me ta nëpërmjet Këshilltarit akademik si dhe në çdo lëndë mundësohet komunikimi me studentët jo vetëm gjatë realizimit të procesit mësimor në auditor, por edhe jashtë auditorit nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike (e-mail, rrjete sociale etj). Në këtë mënyrë, GVJ konstatoi se personeli akademik ka qenë në vazhdimësi i disponueshëm për zhvillimin e konsultimeve për çështje specifike si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve e shqetësimeve individuale të studentëve në lidhje me procesin mësimor. [Ev. Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>GVJ konstatoi se për të mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve, institucioni ka vepruar në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Së pari, në përmirësimin e infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditorë të paisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies; - Së dyti, nëpërmjet modernizimit të bazës laboratorike dhe mbajtjes së saj në gatishmëri për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor; - Së treti, nëpërmjet krijimit të oportuniteteve për stafin akademik nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit për të përsosur metodat e mësimdhënies;



	<p>- Së katërti duke hartuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies.</p> <p>[Ev. Udhëzues për zhvillimin e metodave të mësimdhënies]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga shqyrtimi CV të stafit akademik, GVJ konstatoi se fushat e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me modulet/lëndët që mbulojnë [Ev. CV të stafit akademik]. Gjithashtu nga takimi i zhvilluar me studentët dhe nga rezultatet e pyetsorit të studentëve, rezultoi se personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p> <p>[Ev. Takime në institucion, Raport mbi rezultatet e pyetsorit studentor]</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi se metodat e mësimdhënies janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve si nga vetë pedagogët për lëndët që mbulojnë ashtu edhe nga studentët (nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies) si dhe nga drejtuesit e Grupeve Mësimore Kërkimore. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve për çdo program studimi i cili plotësohet në fund të çdo semestri shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme [Ev. Takime në institucion]. Kjo pasqyrohet në hartimin nga ana e DSHK të planit të masave për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Referuar planit të masave hartuar në mars 2020, për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i literaturës që i përket autorëve më të mirë të asaj fushe por dhe botimeve më të fundit; • Përdorimi i teknikave bashkëkohore në mësimdhënie dhe zhvillimi i mësimin në mënyrë interaktive; • Konkretizimi i teorisë përmes shembujve praktikë; • Përfshirja e studentëve në analizimin e punimeve shkencore të autorëve vendas apo të huaj duke nxitur dialogun dhe stimuluar mendimin kritik përmes dhënies së konkluzioneve dhe rekomandimeve; • Përfshirja e sa më shumë rasteve praktike të studimit gjatë orëve të seminareve të ofruara për t'u punuar nga pedagogu apo të zgjedhura nga vetë studenti. <p>[Ev Plani i masave në departament për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe</p>	<p>Nga takimet online me studentët dhe pedagogët e angazhuar në këtë program studimi GVJ konstatoi se personeli akademik përdor metoda të ndryshme (që varen edhe nga specifika e lëndëve) për të rritur</p>

<p>diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>interesimin për orën e mësimit dhe për të rritur shkallën e përvetësimit të informacionit të transmetuar. Spjegimi i leksionit shoqërohet me prezantime powerpoint si dhe me materiale të tjera ilustruese, ndërsa pjesët praktike shoqërohen me diskutime në orët e seminareve si dhe me zgjidhje të problemeve të caktuar në seancat laboratorike. Një sfidë e veçantë ka qenë dhe vazhdon të jetë zhvillimi i orëve të mësimit në kushtet e pandemisë. Në këto kushte përdoret kryesisht platforma Google Classroom nëpërmjet të cilës postohen edhe materialet për çdo temë mësimore si dhe zhvillohen Quize të ndryshme. [Ev. Takime në institucion].</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga takimet me studentët dhe pedagogët e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”, GVJ konstatoi se ka një tendencë në rritje për angazhimin e studentëve në punë praktike të cilat inkurajojnë sensin e autonomisë dhe synojnë zgjidhjen e problemeve të caktuar [Ev. Takime në institucion]. Ky element konkretizohet nëpërmjet detyrave të kursit dhe punëve laboratorike. Në rastin e detyrave të kursit, të cilat në mjaft raste organizohen në grup, nuk mungon edhe ndjekja e vazhdueshme nga ana e pedagogut përkatës dhe asistimi prej tij për tejkalimin e problematikave. [Ev. RVB, Takime në institucion].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.3


Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga vizita virtuale e realizuar në institucion si dhe nga informacioni i disponueshëm në DVV, GVJ konstatoi se procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. [Ev. Vizita virtuale e ambienteve]</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita virtuale në institucion, GVJ konstatoi se ambientet në të cilat zhvillohet procesi mësimor janë të paisura me infrastrukturën e nevojshme për një zhvillim cilësor të këtij procesi, duke filluar që nga elementët bazikë si tabela (dërrasa e zezë) e deri te gjithë instalimet e nevojshme për përdorimin e videoprojektorit. Gjithashtu rrjeti WiFi është i disponueshëm në gjithë ambientet e Godinës C ku zhvillohet procesi mësimor i programit si dhe në një prej ambienteve është instaluar një smart board i cili ndihmon në zhvillimin cilësor të procesit mësimor.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p>Një kontribut i rëndësishëm ofrohet nëpërmjet bazës laboratorike, e cila në drejtim të paisjeve kompjuterike të nevojshme për zhvillimin e seancave laboratorike, është e viteve të fundit dhe e paisur me softet e nevojshme të cilat janë të licensuara.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Për nga vetë profili i programit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” në masën më të madhe elementët formues të programit funksionojnë mbi bazën e një infrastrukture informatike solide dhe që ndjek ndryshimet e shpejta në këtë fushë. GVJ konstatoi se infrastruktura IT mbështet plotësisht realizimin e procesit mësimor. Referuar RVB dhe takimeve online GVJ u njoh me funksionimin në UV të platformës dixhitale të menaxhimit UVMS, e cila u mundëson studentëve të zgjedhin kurset e studimit, të marrin informacion mbi vlerësimin e kryer nga pedagogu etj. [Ev. https://uvms.univlora.edu.al/user/login]</p> <p>Në mënyrë të veçantë roli i platformës dixhitale ka qenë shumë i rëndësishëm gjatë pandemisë.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga bisedimet e zhvilluara me personelin akademik dhe studentët, GVJ u informua se literatura bazë është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike. Paralelisht biblioteka është angazhuar në një proces të dixhitalizimit të literaturës bazë. Gjithashtu studentëve u vihen në dispozicion edhe leksionet (të shkruara ose Powerpoint), të cilat përmbajnë një informacion më të përditësuar. Për vetë zhvillimet e shpejta të shkencave kompjuterike, studentëve u vihet në dispozicion edhe një literaturë e gjerë ndihmëse në gjuhë të huaj [Ev. <i>Vizita virtuale e bibliotekës</i>]</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Bibliotekat të cilat shfrytëzohen në kuadër të programit të studimit (dhe më gjerë nga FSHTN) janë biblioteka në godinës C me një kapacitet prej 23 vendesh dhe ajo Qëndrore në godinën A me një kapacitet prej 60 vendesh. Biblioteka Qëndrore ka një orar të zgjatur, ora 8:00-20:00, ndërsa biblioteka C funksionon me një orar më të kufizuar 8:00-16:00. Në bibliotekën qëndrore janë të disponueshëm edhe kompjuterat për studentët. Nga analiza e kryer, rezultoi se shkalla e shfrytëzueshmërisë së bibliotekës është rreth 67%. Për të mundësuar pasurimin e bibliotekës me botime të fundit, në mënyrë periodike realizohen blerje dhe konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin 2016-2017 për FSHT136 tituj me 728 vëllime (shqip+anglisht); - Për vitin 2017-2018 për FSHT 100 tituj me 501 vëllime (shqip+anglisht). <p>Për vitin akademik 2018-2019 ishte parashikuar dhe është realizuar tashmë blerje e veçantë vetëm me literaturë në gjuhën angleze posaçërisht për FSHTN. [Ev. <i>Vizita virtuale e bibliotekës; Informacion i sektorit të Bibliotekës Shkencore</i>]</p>

<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët, nëpërmjet linkut në faqen web të UV, aksesojnë shërbimin e bibliotekës online “U-LIBRARY” ku ka një literaturë të bollshme në fushat që lidhen me shkencat kompjuterike [Ev. RVB; https://ulibrary.rash.al/; Vizita virtuale në bibliotekë]</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ u njoh me 2 laboratorët në shërbim të procesit mësimor për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” dhe konstatoi se ata janë të paisur me kompjutera të kohës dhe me softuerët e nevojshëm për të realizuar punët e laboratorit si dhe detyrat e projektet. Për arsye të shfrytëzimit të laboratorëve edhe nga programe të tjerë studimi, studentët mund të shfrytëzojnë edhe kompjuterat e bibliotekës qendrore (e cila ka orar më të zgjatur).</p> <p>[Ev. Vizita virtuale e ambienteve dhe bibliotekës; RVB].</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Personeli akademik i DSHK është njohur me platformën Moodle, për të mundësuar iniciimin e përdorimit të saj si një mjedis e-learning me synimin që të përgjithësohet përdorimi i kësaj platforme [Ev. Trajnimi me pedagogë mbi platformën Moodle]. Aktualisht, në kushtet e pandemisë përdoret kryesisht platforma Google Classroom nëpërmjet të cilës postohen edhe materialet për çdo temë mësimore si dhe zhvillohen Quize të ndryshme. Gjithashtu për të mundësuar komunikimet online (në kuadër të zhvillimit të procesit mësimor) përdoret edhe Google Meet. [Ev. Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm garantuar nga platforma dixhitale e menaxhimit UVMS, e cila u mundëson studentëve të zgjedhin kurset e studimit, të marrin informacion mbi vlerësimin e kryer nga pedagogu etj. [Ev. Takime në institucion; RVB; https://uvms.univlora.edu.al/user/login].</p> <p>Po ashtu pedagogët nëpërmjet kësaj platforme transmetojnë gjithë informacionin përsa i përket vlerësimit të studentëve në lëndët e ndryshme. Aksesit në këtë platformë është i individualizuar dhe realizohet nëpërmjet llogarisë personale që disponojnë si pedagogët ashtu edhe studentët e UV.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Procedura e përzgjedhjes së temave të diplomave dhe e mënyrës së drejtimit të tyre është përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” dhe në Rregulloren e Diplomimit të FSHTN [Ev. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike; Rregullore e diplomimit në FSHTN]. Një vendim Senati i vitit 2017 përcakton si prag të notës mesatare që i jep të drejtë studentit të diplomohet duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome për ciklin e parë të studimeve notën 9 [Ev. Vendim Senati Nr.9 datë 26.01.2017].</p>

	GVJ është i mendimit që ky prag është relativisht i lartë dhe redukton shumë numrin e studentëve që mund të përgatisin dhe mbrojnë një punim diplome (praktikisht i korresponon studentëve ekselentë).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Natë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në shërbim të sigurimit të cilësisë në UV është ngritur NJSBCVI e cila, ndërmjet të tjeurve, vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore si dhe vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit. Përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimit të brendshëm mbështeten në analizën statistikore të të dhënave, në konstatime të nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetsorët dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin ndihmës akademik dhe administrativ si dhe studentët. [Ev. Draft Rregullorja e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë].
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	DSHK është përgjegjës për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”. Në këtë mënyrë, DSHK është njëkohësisht përgjegjës për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, detyrë të cilën e realizon me ndihmën e Grupeve Mësimore Kërkimore si dhe në bashkëpunim me NJSBCVI. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve për çdo program studimi i cili plotësohet në fund të çdo semestri shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. Kjo pasqyrohet në hartimin nga ana e DSHK të planit të masave për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. [Ev. Plani i Masave për përmirësimin e cilësisë në DSHK].
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	UV ka miratuar udhëzuesin mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit [Ev. Udhëzues për zhvillimin e metodave të mësimdhënies]. Objektivi kryesor i këtij Udhëzuesi ka të bëjë me shqyrtimin, diskutimin dhe transferimin e praktikave më të mira inovative në mësimdhënie për IAL, duke nxitur përdorimin e tyre në to.

<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>DSHK përbëhet nga personel akademik në moshë relativisht të re. Përsa i përket kualifikimit të PAE, 5 prej tyre janë me gradën shkencore “Doktor”, 3 janë në proces të përgatitjes së doktoratës, ndërsa 5 janë me diplomën Master i Shkencave. Kjo tablo e bën të domosdoshme avancimin në drejtim të kualifikimit sidomos për PAE Master i Shkencave. Gjithashtu edhe PAE me gradën shkencore “Doktor” e ka të nevojshme rritjen e shkallës së kualifikimit, për të avancuar në drejtimin e fitimit të titujve Profesor i Asociuar dhe Profesor. Nga bisedimet me pedagogët dhe drejtuesin e DSHK, GVJ konstatoi se kjo problematikë është në fokusin e punës së secilit dhe të Departamentit në përgjithësi [Ev. Takime në institucion]. Kualifikimit të vazhduar shkencor i shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me IAL jashtë vendit konkretizuar nëpërmjet mobiliteteve të stafit akademik të DSHK.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstatoi se në rang institucioni janë organizuar trajnime për shkrim projektesh si dhe trajnime për mësues (inicuar në kuadër projekti) [Ev. Raporti i RDC, Takime në institucion]. UV ka miratuar udhëzuesin mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit [Ev. Udhëzues për zhvillimin e metodave të mësimdhënies].</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Përmirësimi të aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja i kanë shërbyer dhe mobilitetet e akademik në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit.</p> <p>[Ev. Marrëveshje dhe projekte të UV].</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e prishmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Përmirësimi i metodave të mësimdhënies ka ecur paralelisht me përmirësimin e bazës laboratorike. Në këtë mënyrë ka qenë e mundur që në aspektet praktike që kanë të bëjnë me realizimin e projekteve dhe laboratorëve të nxiten iniciativat individuale dhe të kultivohet puna në grup. Problematika që ka të bëjë me metodat e mësimdhënies është objekt edhe i pyetësorëve të studentëve që realizohen në fund të çdo semestri e që shërbejnë si bazë për përmirësime të mëtejshme [Ev. Takime në institucion]. Në planin e masave të hartuar sëfundmi nga DSHK gjejmë ndërmjet të tjerave edhe elementë që lidhen me përmirësimin e metodave të mësimdhënies si përdorimine teknikave bashkëkohore në mësimdhënie dhe zhvillimine mësimi në mënyrë interaktive, konkretizimine teorisë përmes shembujve praktikë, përfshirjen e studentëve në analizimin e punimeve shkencore të autorëve vendas apo të huaj duke nxitur dialogun dhe stimuluar mendimin kritik përmes dhënies së konkluzioneve dhe rekomandimeve, përfshirjen e sa më shumë rasteve praktike të</p>

	studimit gjatë orëve të seminareve të ofruara për t'u punuar nga pedagogu apo të zgjedhura nga vetë studenti etj. [Ev Plani i Masave për përmirësimin e cilësisë në DSHK]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Rregulloret në të cilat përcaktohen kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale lidhur me programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” janë në nivel institucioni, në nivel njësie bazë dhe në nivel programi studimi, respektivisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e UV e ndryshuar; - Rregullore e DSHK; - Rregullore e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike; <p>GVJ u njoh me këto rregullore [Ev. Rregulloret] dhe është i mendimit se në to përcaktohen qartë elementët që lidhen me kriteret dhe menyrën e testimit të njohurive. Shënojmë këtu që Rregullorja e UV bëhet publike në faqen web të institucionit [https://univlora.edu.al/rregullorja/], veçse versioni i publikuar nuk është përditësuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015.</p> <p>Njohja e studentëve me rregulloren specifike të programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” bëhet që në fillimin e studimeve Bachelor, ndërsa elementë me të cilët eventualisht mund të ballafaqohen gjatë periudhës së studimeve trajtohen nga Këshilltari Akademik, përgjegjësi i DSHK ose përgjegjësit e Grupeve Mësimore Kërkimore. [Ev. Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Metodologjia e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore është specifike për secilën lëndë, ndaj njohja me to realizohet nga titullari i lëndës që në orën e parë të mësimin. GVJ konstatoi se këta elementë janë të parashikuar në syllabuset e lëndëve të cilët janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. [Ev. Syllabuset e lëndëve].</p>

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.				
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, të cilat për lëndë të ndryshme kanë elementë të përbashkët, por edhe specifika që lidhen me natyrën e lëndës dhe aktivitetet formuese përkatëse. Përgjithësisht, GVJ konstatoi se vlerësimi final përbëhet nga komponentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrolli i pjesshëm me peshë 20% deri 30%; - Vlerësimi vjetor (detyra, seminare, laboratorë), me peshë 10% deri 20%; - Kontrolli final, me peshë 60% <p>[Ev. Syllabuset e lëndëve].</p> <p>Përsa i përket diplomimit, realizohet me provim (në se nuk plotësohet kriteri i notës mesatare ≥ 9) dhe me temë diplome.</p> <p>[Ev. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike; Rregullore e diplomimit në FSHT]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Bazuar në syllabuset e lëndëve, GVJ konstatoi se, për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” kontrolli dhe vlerësimi i njohurive realizohet gjatë gjithë vitit dhe mbyllet me provimin përfundimtar, pesha e të cilit në vlerësimin e përgjithshëm është 60%. Elementët e tjerë që merren në konsideratë gjatë vlerësimit të lëndës janë provimi i pjesshëm (me një peshë që varion nga 20% në 30%) dhe vlerësimi që lidhet me detyrimet e tjera të lëndës siç janë laboratorët, seminarët dhe detyra e kursit (me një peshë që varion nga 10% në 20%)</p> <p>[Ev. Syllabuset e lëndëve;].</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Në UV aktualisht nuk është vënë në zbatim ndonjë sistem elektronik i testimit të vlerësimit. Elementë të testimit dhe vlerësimit nëpërmjet sistemeve elektronike janë të pranishëm në situatën aktuale të pandemisë ku, nëpërmjet Google Classroom, realizohen Quize të ndryshme. [Ev. Takimet online me institucionin].</p>

<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar RVB, në DSHK, testimi e vlerësimi i njohurive për programin e studimeve Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” kryhet nga pedagogët përgjegjës të lëndës. Sipas RVB, në rastin kur për një lëndë është përgjegjës për leksione, seminare dhe laboratorë vetëm një pedagog, vlerësimi kryhet vetëm prej tij. Në rastin kur për aktivitetet mësimore të një lënde janë përgjegjës më tepër se një pedagog, vlerësimi kryhet me pjesëmarrjen e të gjithë pedagogëve, por përgjegjës me firmë si dhe për regjistrimin e notave në UVMS është titullari ilëndës [Ev. RVB; Kalendari i provimeve në DSHK]. GVJ është i mendimit që, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, në çdo rast, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale duhet të realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p> <p>Përsa i përket Komisioni të provimit të diplomës apo mbrojtjes së temës së diplomës, ai ka në përbërje 5 anëtarë, duke respektuar në këtë mënyrë kriterin përkatës. [Ev. Procedurë diplomimi nëpërmjet provimit të diplomës].</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve online me institucionin GVJ konstatoi se testimi i njohurive, dijeve me shkrim nuk zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim, por sigurohet infrastruktura e nevojshme e monitoruar me personel [Ev. RVB; Takime në institucion].</p> <p><u>GVJ është i mendimit që, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, minimalisht të garantohet zhvillimi i provimeve në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim.</u></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimet në institucion dhe referuar RVB, GVJ konstatoi se procedura e kontrollit të njohurive zhvillohet sipas rregulloreve përkatëse [Ev. RVB; Rregullore e programit të studimit; Rregullore e UV]. Studentëve, brenda 48 orëve nga zhvillimi i provimit, u lind e drejta të konsultohen me tezat e korrigjuara prej pedagogut dhe eventualisht gjatë këtij procesi vihen në dukje pikat e dobta për të cilat kërkohet përmirësim dhe studentët marrin këshillime për të tejkaluar mangësitë e vërejtura. Përgjithësisht elementë të tillë të cilët merren në konsideratë në vlerësimin përfundimtar si detyrat e kursit dhe laboratorët, shoqërohen me komente gjatë dorëzimit apo mbrojtjes së tyre.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Rregullimi i problematikës lidhur me plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra etj. bëhet duke ju referuar dispozitave përkatëse të Kodit të Etikës dhe të rregulloreve përkatëse [Ev. Kodi i Etikës, Rregullore e programit të studimit; Rregullore e UV]. Për të shmangur kopjimin e projekteve ose detyrave të kursit, pedagogu kushtëzon kryerjen e rasteve të ndryshme të studimit nga ana e studentëve. [Ev. RVB].</p>

<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësiwe profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga diskutimet me pedagogë dhe studentë të programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”, GVJ konstatoi se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësiwe profesionale bazohen mbi meritën, i korrespondojnë një vlerësimi të shtrirë përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës duke reflektuar gjithë komponentët e formimit [Ev. Takime në institucion]. Gjithashtu, u konstatua se rezultatet jepen në kohë, bazuar në përcaktimet e rregulloreve përkatëse.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentëve, brenda 48 orëve nga zhvillimi i provimit, u lind e drejta të konsultohen me tezat e korrigjuara prej pedagogut dhe rezultatin e vlerësimit në pikë për secilin element duke paraqitur eventualisht edhe pretendimet e tyre [Ev. Rregullore e programit të studimit; Rregullore e UV]. Njohjen me rezultatin e vlerësimit të tezës studenti e bën nëpërmjet sistemit të informacionit UVMS. Nëse studenti nuk e pranon vlerësimin e kryer, mund të paraqesë ankimimin e tij pranë Përgjegjësit të Departamentit. [Ev. Procedurë ankimimi në departament].</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga një komision i ngritur nga Përgjegjësi Departamentit. Komisioni shikon gjithë procedurat e ndjekura për kërkesën apo ankimimin si dhe pretendimet e kërkuarit dhedhel me propozime drejtuar Përgjegjësit të Departamentit ose instancave më të larta, në varësi të kompetencave të kërkuara për vendimmarrje.</p> <p>GVJ u njoh me një procedurë ankimimi dhe gjithë hapat e ndjekur për trajtimin e saj dhe konstatoi se ato janë në përputhje me rregulloret e institucionit [Ev. Procedurë ankimimi në departament].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi III.7</p> <p>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësiwe krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” mundëson fitimin e njohurive dhe aftësiwe profesionale për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Administrim të rrjeteve kompjuterike, projektim dhe zhvillim i aplikacioneve desktop apo mobile, programim desktop apo web; - Projektimin, zhvillimin dhe vlerësimin e zgjidhjeve bazuar në specifikat dhe kërkesat e fushës, mirëmbajtjen, hartimin, ose

	<p>zhvillimin e projekteve në fusha të ndryshme të shkencave kompjuterike;</p> <p>- Për vehtësimin e njohurive të moduleve specifike, të natyrës teorike ose praktike lidhur me tendencat e reja të disiplinave të shkencave kompjuterike;</p> <p><i>GVJ është i mendimit mënyra e zhvillimit të programit të studimit (me integrimin e detyrave e laboratorëve) krijon mundësi për zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve si në drejtim të programimit, sigurisë së rrjeteve kompjuterike, etj.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, për vetë natyrën e tij. Gjuha e huaj është e përfshirë në vitin e parë të studimeve dhe jep një ndihmesë të konsiderueshme në shfrytëzimin në vijim të literaturës në gjuhë të huaj si dhe lehtëson oportunitetet e mobiliteteve për studentët në institucione homologe të arsimit të lartë jashtë vendit. Referuar programit aktual, në të mungojnë lëndë të shkencave sociale, humane apo të komunikimit. [Ev. Plani mësimor i programit, RVB].</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve nga vetë pedagogët për lëndët që mbulojnë, nga studentët (nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies) si dhe nga drejtuesit e Grupeve Mësimore Kërkimore. Nga analizat e kryera në fund të semestrit, GVJ vëren se ka shembuj të analizave të procesit mësimor ku pedagogët kanë siguruar feedback mbi njohuritë e përfuara nga studentët. [Ev. Raport aktiviteti grupi mësimor].</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Referuar RVB, pedagogu, përpara realizimit të provimit (i pjeshem ose final) orienton studentët duke vënë në pah çështjet më të rëndësishme të materialit të trajtuar si dhe një strukturë në lidhje me tezën, duke përcaktuar peshën që elementët e tezës do të zenë në testim. Konsultimet që pedagogët zhvillojnë sipas kerkesës së studenteve orientojnë më mire studentet në procesin e të mësuarit [Ev. RVB; Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga DVV dhe takimet në institucion GVJ u informua mbi zhvillimin në mënyrë të rregullt të orëve të hapura me pjesëmarrjen e studentëve dhe të pedagogëve. Qëllimi i seminareve ka qenë nxitja dhe inkurajimi i studentëve drejt punës kërkimore në mënyrë të pavarur, bashkëpunimi me njeri tjetrin si dhe aftësimi për të prezantuar punën e tyre. [Ev. Seminarët e hapura në departament]. Veç kësaj në DSHK janë realizuar seminare, qëllimi i të cilëve ka qenë sjellja e të</p>


	<p>rejave në fushat përkatëse kërkimore-shkencore. Në këto seminare kanë marrë pjesë dhe studentët.</p> <p>[Ev. Referime të pedagogëve në departament].</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikant profesionale.</p>	<p>Nga studimi i planit mësimor GVJ vëren se ka një vëllim të konsiderueshëm seancash laboratorike (në rret 50% të lëndëve janë parashikuar seanca laboratorike) [Ev. Plani mësimor].</p> <p>Megjithatë, referuar takimit online me studentët, ka vend akoma për rritjen e vëllimit të krediteve për seancat laboratorike. Laboratorët në dispozicion të realizimit të programit janë një mbështetje e mirë për realizimin cilësor të punëve të planifikuara laboratorike, duke mundësuar përvehtësimin më të mirë të lëndës dhe zhvillimin e kompetencave individuale. [Ev. Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Nga takimi me pedagogët dhe studentët, GVJ konstatoi se aplikohen forma të punës në grup për realizimin e një detyre apo projekti, duke zhvilluar në këtë mënyrë edhe elementë të tillë si diskutimet për problemin dhe menaxhimi i ndarjes së punës, interpretimi dhe zgjidhja e problemit, integrimi pjesëve individuale në një të tërë, referimi i materialit përfundimtar nga grupi etj.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Zhvillimi i orëve të hapura me pjesëmarrjen e studentëve dhe të pedagogëve i shërben krijimit të një klime të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve. [Ev. Seminaret e hapura në departament]. Këtij qëllimi i kanë shërbyer dhe seminaret e hapura me referime të pedagogëve të DSHK, në të cilat kanë marrë pjesë dhe studentë, qëllimi i të cilëve ka qenë sjellja e të rejave në fushat përkatëse kërkimore-shkencore. [Ev. Referime të pedagogëve në departament].</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Ndër objektivat strategjike të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" mund të përmendim përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor me qëllim aftësimin e tyre për studimet master apo në fusha të tjera me të cilat lidhet programi. Kjo mund të arrihet, ndërmjet të tjerash, nëpërmjet krijimit të një baze financiare të qëndrueshme që mundëson infrastrukturë të përgjithshme për edukimin, paisje për mësim, materiale mësimore, laboratorë dhe mbështetje të kërkimit shkencor.</p> <p>[Ev.Plani Strategjik i Programit të Studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"].</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të DVV, GVJ konstatoi se UV ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit [Ev. Marrëveshje dhe projekte të UV]. Marrëveshjet me institucione homologe jashtë vendit i kanë shërbyer mobilitetit të studentëve.</p>

	Gjithashtu, në një masë të madhe, i kanë shërbyer edhe mobilitetit të pedagogëve, të cilët nëpërmjet eksperiencës së përfituar dhe transmetimin e saj nëpërmjet formave të ndryshme të mësimdhënies, lehtësojnë mobilitetin e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	GVJ konstatoi se procedura për provimin final ose mbrojtjen e diplomës është objekt i një rregulloreje të veçantë [Ev. Rregullore e diplomimit në FSHTN]. Kjo rregullore si dhe elementët që lidhen me diplomimin e që janë pasqyruar edhe në rregulloret e tjera të UV, u bëhet e njohur studentëve në fillim të semestrit të fundit të studimeve Bachelor.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Diplomimi për programin e studimit realizohet me provim (në se nuk plotësohet kriteri i notës mesatare ≥ 9) dhe me temë diplome. [Ev. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike; Rregullore e diplomimit në FSHTN]. Nga takimi online në institucion, GVJ u informua se vetëm një student ka mundur të kalojë prapen e notës 9 e të diplomohet me temë diplome. Për provimin final, DSHK vë në dispozicion të studentëve bankën e pyetjeve, minimalisht 3 muaj përpara provimit të diplomës.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bazuar në DVV, GVJ konstatoi se lëndët të cilat kanë peshën kryesore në bankën e pyetjeve janë lëndët karakterizuese [Ev. Procedurë diplomimi nëpërmjet provimit të diplomës], dhe se synohet që në bankën e pyetjeve të përfshihen elementë të cilët të certifikojnë formimin e studentit në fushën e shkencave kompjuterike, niveli bachelor.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final	Personeli akademik angazhohet nëpërmjet ofrimit të konsultimeve për përgatitjen e provimit final. Në rastin e temës së diplomës, udhëheqësi bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me studentin për elementë të tillë si përcaktimi i strukturës së punimit dhe objektivave, përgatitja e planit të punës me afatet përkatëse, përzgjedhja e literaturës, hartimi



apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	i grafikut e konsultimeve të programuara (minimalisht tre konsultime), përcaktimin e infrastrukturës së nevojshme laboratorike apo matjeve që duhen kryer, etj. [Ev. Rregullore e diplomimit në FSHTN]. Duhet theksuar se për shkak të kriterit të notës mesatare ≥ 9 , vetëm një student është diplomuar me temë diplome.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	RVJ konstatoi se egzistojnë të gjitha mundësitë për të shfrytëzuar bazën laboratorike të FSHTN për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit. Gjithashtu, në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, mund të ofrohen mundësi për të kryer matje apo teste edhe në biznese apo institucione që mbulojnë problematikën që lidhet me temën e diplomës.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Referuar Rregullores së Diplomimit të FSHTN udhëheqësi i temës duhet të: <ul style="list-style-type: none"> - Miratojë temën e diplomës; - Miratojë programin e punës së diplomantit; - Të asistojë udhëheqjen e diplomës; - Të rekomandojë literaturën për thellimin teorik; - Të mbikqyrë çdo javë ecurinë e diplomës; - Të rekomandojë ndryshime nëse gjykohet e nevojshme; - Të ofrojë konsulencë të specializuar në fusha specifike; - Të organizojë kontrollet e diplomës. <p>Gjithashtu, udhëheqësi ndihmon studentin në mbledhjen e literaturës dhe burimeve të nevojshme për realizimin e tezës së diplomës, vlerëson në se puna është në përputhje me planin dhe jep rekomandime në lidhje me çështjet që mund të lindin gjatë punës. Veç kësaj, është detyra e udhëheqësit për të ndihmuar studentin në arritjen e formës përfundimtare të tezës së diplomës, duke patur parasysh kërkesat formale dhe përmbajtjen e saj. [Ev. Rregullore e diplomimit në FSHT].</p>
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Si në rastin e provimit final ashtu edhe në rastin e mbrojtjes së diplomës studenti vlerësohet me notë nga komisioni përkatës i mbrojtjes i cili ka në përbërje 5 anëtarë. [Ev. DVV, Takime në institucion]
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve të ciklit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike", studentit i vihet në dispozicion diploma (sipas modelit të miratuar nga MASR) dhe suplementi i diplomës së bashku me listën e notave. [Ev. Model diplome; Suplementi i diplomës Bachelor në Shkenca Kompjuterike].
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë	Referuar RVB, versioni zyrtar i programit të plotë të studimit u vihet në dispozicion studentëve të diplomuar vetëm pas kërkesës së tyre [Ev. RVB].




zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.									
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Referuar DVV, rezultati i provimit ose mbrojtjes së diplomës ruhet në Sekretarinë Mësimore të DSHK dhe Sekretarinë Mësimore të FSHTN [Ev. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike]. Gjithashtu, në Sekretaritë mësimore mbahet regjistri bazë i studentëve me të dhënat e tyre personale si dhe vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit [Ev. Pjesë nga regjistri themeltar i studentëve]. Krahas versionit të shkruar (letër), për menaxhimin e përditshëm mbahet edhe versioni elektronik i informacionit [Ev. RVB, Takim në Sekretarinë Mësimore].								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit	Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka të ngritur Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore si strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucioni e cila është në varësi të Rektorit, dhe funksionon mbi bazen e kuadrit ligjor të institucionit dhe konform ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë. [Ev. Kuadri ligjor ku bazon veprimtarinë Zyra e Burimeve Njerëzore]. Kjo drejtori përbëhet nga: a. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll – Arkivës; b. Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit; c. Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun; [Ev. Statuti i UV-së]



<p>ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Në mbledhjen me përfaqësues të kësaj drejtorie u theksua që pjesë përbërëse e saj është edhe Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit i cili në Statut rezulton të jetë strukturë përbërëse e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional. [Ev. Mbledhja nr.6].</p> <p>Sektori i Burimeve Njerëzore është përgjegjës për mbledhjen, regjistrimin, ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave personale të personelit akademik, ndihmës – akademik dhe administrativ. Në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll – Arshivës janë të angazhuar 4 persona si personel administrativ, në Sektorin e Teknologjisë dhe Informacionit 4, dhe në Sektorin e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun 2. Në total kjo drejtori ka 13 specialistë si staf administrativ. Sektori i Burimeve Njerëzore është përgjegjës për administrimin e të dhënave në lidhje me personelin ndërsa Sektori i Promovimit Akademik dhe Botimeve Shkencore [Ev. Statuti i UV-së, neni 13] është përgjegjës për administrimin e progresit shkencor të stafit akademik. Institucioni garanton mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetit në përputhje me ligjin nr. 9887 date 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Udhëzimin nr.07 date 09.06.2010 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e arsimit” [Ev. Kuadri ligjor ku bazon veprimtarinë Zyra e Burimeve Njerëzore; Ev. Rregullore e UV-së, neni 90]</p> <p>Të dhënat personale për stafin akademik dhe personelin ndihmës akademik mbahen në mënyrë manuale nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Regjistrimit si edhe në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit që administrohet nga personeli administrativ i Sektorit të IT-së. Përditësimet në dosjet e personelit akademik bëhen çdo vit në bazë të Rregullores së Sektorit të Burimeve Njerëzore e miratuar nga Senati Akademik dhe e shprehur edhe në nenin 90 të Rregullores së UV-së.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik, ndihmës-akademik, personelit administrativ në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, akteve ligjore dhe nëngjore të shprehur në Statut dhe në Rregulloren e UV-së. Institucioni garanton zbatimin e procedurave të qarta në lidhje me rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, si edhe të personelit ndihmës – akademik. Bazuar në Statut neni 31, pika 23-26, përcaktohet Rektori si personi përgjegjës për shpalljen e vendeve të lira të punës përmes shpalljes së njoftimit dhe publikimit në websitine UV-së. Ai është përgjegjës edhe për miratimin e kriteve të punësimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si edhe të personelit ndihmës- akademik me karakter mësimor sipas propozimeve të bëra nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike në</p>

	<p>Fakultetin e Shkencave Teknike. Kriteret e punësimit janë të përcaktuar qartë në Statut, në Rregulloren e UV-së dhe në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Teknike [Ev. Rregullore e ndryshuar e UV-së neni 27 dhe 28; Ev.Statuti i UV-së –neni 31, 34 dhe 38; Ev. Procedura e punësimit në Departamentin e Shkencave Kompjuterike]. Në takimet e zhvilluara me përgjegjësën e Departamentit të Shkencave Kompjuterike dhe Drejtues të Fakultetit të Shkencave Teknike GVJ konstaton përpjekje të përthithjes se kandidaturave më të mira në drejtim të punësimit të stafit akademik më kohë të plotë.</p> <p>GVJ u njoh me procedurën e plotë të shpalluar për 8 pedagogë me profil Informatikë, Shkenca Kompjuterike, Teknologji Informacioni ose Informatikë Ekonomike. Procedura e rekrutimit fillon në 08.09.2016 dhe mbaron në 16.01.2017.</p> <p>[Ev.procedura e punësimit në Departamentin e Shkencave Kompjuterike].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>UV ndjek procedura të qarta rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të stafit akademik të ftuar si edhe stafit ndihmës-akademik. Këto procedura janë të përcaktura qartë në Statut, Rregulloren e UV –së dhe në Rregullore të Fakultetit të Shkencave Teknike. Departamenti i Shkencave Kompjuterike harton edhe kriteret të veçanta në lidhje me rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Preferohen si kriteret të veçanta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kandidate me tituj akademik Prof. Asoc dhe gradën Doktor; • Studente në ciklin e Studimeve Doktor në profilet e Shkencave Kompjuterike brenda dhe jashtë vendit; • Të diplomuar në Master i Shkencave në profilet e Shkencave Kompjuterike jashtë vendit të njohura dhe të ekuivalentuara nga MASR; • Të diplomuar në Master i Shkencave dhe Bachelor në Universitete Publike brenda vendit në profilet e përcaktuara më lart; • Mesatarja aritmetike e përbashket e diplomave që zotëron të jetë jo më pak se 8 (tetë); <p>UV harton procedurë të veçantë për personelin akademik të ftuar. Personeli akademik i ftuar thirret për nevoja të departamentit bazuar në nenin 62 te Ligjit nr.80 datë 22.07.2015 si edhe nenit 47 të Statutit të UV-së. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar bëhet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike pasi janë identifikuar modulet ku angazhohen, vëllimi i orëve mësimore që ato do të kryejnë si edhe kualifikimi i kandidatëve.</p> <p>[Ev.Statuti UV-së – neni 47, neni 30; Ev. Rregullore e UV-së, neni 16; Ev. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Teknike].</p>




	<i>[Ev.procedura e punësimit ne Departamentin e Shkencave Kompjuterike].</i>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UV ndjek procedura të qarta të rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të stafit akademik të ftuar si edhe stafit ndihmës-akademik. Këto procedura janë të përcaktuara qartë në Statut, Rregulloren e UV –së dhe në Rregullore të Fakultetit të Shkencave Teknike. Këto rregulla zbatohen qartë nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore. Bazuar në nenin 51 të Statutit të UV-së, nenit 30 të Rregullores së UV të ndryshuar, nenit 17 dhe 28 të Rregullores së Fakultetit të Shkencave Teknike.</p> <p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike përpara çdo fillim semestri ose gjatë vitit akademik sipas nevojave të parashikuara nga departamenti paraqet në Rektorat për miratim listën emërore të personelit me kontratë të plotë dhe të pjesshme duke iu përmbajtur numrit të miratuar. Konkurrimi për personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes. Neni 28 i Rregullores së UV-së përcakton qartë kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati. Ndër kriteret e përgjithshme citojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kandidati duhet të zotërojë aftësi të nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurron;</i> • <i>Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit profesional me kolegët dhe studentët;</i> • <i>Të mos jetë i dënuar me vendim të formes së prerë të Gjykatës për kryerjen e një krimi;</i> • <i>Të mos ketë marrë me përpara masa disiplinore të largimit nga puna apo të zgjidhjes së kontratës nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë etj;</i> <p>Në lidhje me kriteret e veçanta në Rregulloren e Fakultetit citojmë: “ .. kriteret më specifike përcaktohen në rregulloren e brendshme të njëjësive kryesore” [Ev. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Teknike ,neni 17].</p> <p>GVJ gjeti dëshmi të zbatimit të procedurës së rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme për vitin akademik 2016-2017. GVJ evidentoi pratika të zbatimit të sistemit të vlerësimit me pikë për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta [Ev. Procedura të punësimit në Departamentin e Shkencave Kompjuterike], ndonëse nuk gjeti të shprehura në Rregulloren e UV-së, në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe në Rregulloren e Departamentit të Shkencave Kompjuterike vendosjen e sistemit të vlerësimit me pikë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---


Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë synon në krijimin e një infrastrukture të duhur për zhvillimin e procesit të mësimdhënies. Kjo është e shprehur qartë edhe në Strategjinë e Departamentit të Shkencave Kompjuterike [Ev.- Plani strategjik dhe plani i detajuar i veprimt të DSHK, për periudhën 2018-2024.] dhe në Planin Strategjik të Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike [Ev.- Plani Strategjik i Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike] ku në fokus qëndron krijimi i një baze financiare të qëndrueshme që mundëson infrastrukturë të përgjithshme për sistem edukimi, pajisje dhe akomodim për mësim, materiale mësimore si edhe mjedis social.</p> <p>Programi Bachelor në Shkenca Kompjuterike zhvillohet në Godinën C. Për shkak të situatës së krijuar nga COVID – 19, GVJ nuk mundi fizikisht të vlerësonte gjendjen e infrastrukturës në ambjentet e Godinës C ku zhvillohet procesi mësimor për këtë program studimi por përmes një procesi online nga ana e stafit akademik u zhvillua një vizitë virtuale ku GVJ konstatoi ambjentet e brendshme, laboratorët dhe ambjentet ndihmëse në dispozicion të procesit mësimor. GVJ evidenton përmes dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni që siperfaqjet e mjediseve të Godinës C janë në raport të drejtë me numrin e stafit akademik dhe numrit të studentëve për këtë program studimi. Procesit mësimor kryhet në një godinë të rikonstruktuar në përputhje me standartet e zbatimit në fushën e ndërtimit, në akordancë me standartet për zhvillimin e procesit mësimor në Republikën e Shqipërisë. Klasat, zyrat, laboratorët janë të ndriçuara drejt, të pajisura me të gjithë mjetet didaktike që mundësojnë një zhvillim normal të procesit mësimor.</p> <p>Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë, të pjeshme dhe ndihmës akademik janë të pajisur me bazë logjistike si desktop ose laptop, printer dhe fotokopje për nevoja të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike si dhe akses në internet.</p> <p>Bazuar edhe në punën e bërë nga UV në lidhje me plotësimin e rekomandimeve të bëra nga grupi i akreditimit institucional si edhe në vijim të plotësimit të mungesave të evidentuara në Raportin vjetor të Departamenti të Shkencave Kompjuterike për vitin 2016-2017 ku citojmë: “... në funksion të pjesës praktike të disa prej kurseve si në nivelin Master ashtu edhe në Bachelor, të pajisen laboratorët e</p>



	<p><i>informatikës me platforma softuer që mundësojnë simulimin e njohurive teorike të përftuara në këto kurse.- Zhvillimi i një biblioteke në Departament që të ofrojë për pedagogët dhe studentët librat dhe manualët për lëndët apo softuerët që përdoren në procesin e mësimdhënies”, janë bërë përmiresime në laboratorë dhe është ngritur Biblioteka me një infrastrukturë bashkëkohore. Në këtë drejtim është ndërtuar një klasë model në të cilën është vendosur tabela interactive. [Ev. Plotësimi i rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm, Ev. Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019, Ev.Raporti vjetor UV për vitin 2016-2017].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike zhvillojnë përpjekje në drejtim të mbështetjes së stafit akademik. Kjo është e përcaktuar qartë në Statutin e UV-së dhe në Planin Strategjik 2018-2024 [Ev. Plani Strategjik 2018-2024]. Institucioni synon në përfshirjen e një programi intensiv trajnimi dhe kualifikimi të stafit akademik me kohë të plotë, të stafit ndihmës mësimor duke respektuar procesin Life Long Learning. Institucioni ka marrëveshje ndërkombëtare me shumëuniversitete në rajonin e Ballkanit dhe në Evropë [Ev. Marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Vlorë; Ev. Marrëveshjet e UV të vlefshme për 2016-2020]. Bazuar në raportin e UV për vitin akademik 2018-2019 rezulton një mobilitet i stafit mësimdhënës (2 dalje, 1 hyrje) dhe për trajnim (2 dalje dhe 1 hyrje) me universitetin “Bialystok University & Technology” Poloni dhe me universitetin “Kirchliche Padagogische Hochschule Wien/Krems” për stafin mësimdhënës (2 dalje)[Ev. Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019].</p> <p>Kanë përfituar në total 10 mobilitete të stafit akademik përkatësisht 1 (një) në “Middle East Technical University” Turqi, 4 (katër) në Bialystoc University of Technology-Poloni, 1 (një) në President Stanislaw Wciechowski State University of Applied Science – Poloni, 3 (tre) në Riga Technical University – Letoni, 1 (një) në West Attica University –Greqi [Ev. Mobilitete të DSHK-së];</p> <p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike në kuadër të Strategjisë për trajnimin e vazhdueshëm të kërkuesve të rinj ofron mbështetje, mentorim të stafit të ri akademik.</p> <p>[Ev.Strategjia per Trajnimin e vazhdueshem të Kërkuesve të Rinj; Ev. Takim me stafin akademik];</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike si pjesë përbërëse të UV-së synon në zhvillimin e metodave bashkëkohore në procesin e mësimdhënies. UV ka ngritur edhe Qendrën Studimore Ndërdisciplinore të Zhvillimit</p>




<p>mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Rajonal që është strukturë e veçantë që mundëson ofrimin e metodave inovative dhe trajnimeve në fushën e mësimdhënies.</p> <p><u>Rekomandojmë që në Rregulloren e UV-së të bëhet ndryshimi në emërtesë i kësaj qëndre e cila në këtë Rregullore të miratuar me ndryshimet e fundit sipas vendimit nr. 18 datë 14.07.2015 e quan këtë strukturë Qender Life Long Learning ndërsa në Statut të UV-së (miratuar me vendimin nr.11 datë 27.02.2019) njihet si Qendra Studimore Ndërdisciplinore e Zhvillimit Rajonal.</u></p> <p>Ndonëse kjo qëndër në datë 15.01.2020 ka krijuar Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve, impakti i saj nuk ndihet në programin e studimit të marrë në shqyrtim. Kjo u pranua edhe në takimet e bëra si edhe në RVB. Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka zhvilluar trajnime të shkurtra në lidhje me përdorimin e platformës Moodle si edhe ka zhvilluar një seminar të hapur mbi përdorimin e teknologjisë VR (virtual reality). Nga grupi mësimor kërkimor për vitin 2018 është organizuar seminar i hapur “Sisteme kompjuterike & programin dhe zhvillime software”. [Ev. Tematika dhe materialet e seminarit të hapur në department; Ev. Trajnimi me pedagogë rreth platformës Moodle] duke dëshmuar përpjekje në lidhje me qasjen drej teknikave të reja në fushën e teknologjisë.</p> <p>[Ev. Tematika dhe materialet e seminarit të hapur në department; Ev. Trajnimi me pedagogë rreth platformës Moodle]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Takimet e zhvilluara, dokumentacioni i paraqitur janë tregues të një shfrytëzimi me eficiencë të kapacitetit njerëzor, të stafit akademik dhe të stafit ndihmës mësimor.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Procesi i</p>



përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.



mësimdhënies zhvillohet në Godinë C. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka punuar në tre vitet e fundit në drejtim të përmirësimit të Infrastrukturës mësimore. Kjo punë është zhvilluar si pasojë e mosplotësimit të standardeve në infrastrukturë si edhe në drejtim të plotësimit të rekomandimeve të dhëna nga procesi i fundit i akreditimit institucional të vitit (2017). Bazuar në evidencat e paraqitura dhe nga një vizitë virtuale e mundësuar nga stafi akademik në këtë departament, GVJ vëzhgoi ambjentet mësimore dhe rekreative që disponeshin për studentët në këtë program studimi. Godina C ku zhvillohet edhe ky program studimi është një godinë me 5 kate me një sipërfaqje të shfrytëzueshme dhe në funksion të aktivitetit akademik prej 3800m². Ambjentet e kësaj godine janë në funksion të programeve mësimore të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, pjesë përbërëse e të cilit është edhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike ku zhvillohet programi i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike". Në këtë godinë ndodhen 6 klasa leksioni me kapacitet 610 vende, 3 klasa seminari me kapacitet total 150 vende (50 vende/klase seminari), 14 laboratorë mësimore si edhe bibliotekëe ristruktuar për nevojat e FSHT-së me kapacitet 30 vende. UV ka punuar në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës. Për vitin 2018-2019 janë bërë investime në blerje dhe shpërndarje të pajisjeve elektronike ku Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore ka përfituar në masën e investimit 4,232,760 lekë. UV ka plotësuar kërkesat e FSHTN për pajisjen e tij me kompjutera, videoprojektore, fotokopje, printera dhe pajisje të tjera elektronike. Në këtë fakultet është bërë model edhe një klasë interaktive e cila është e pajisur edhe me tabelë elektronike. Në kuadër të plotësimit të nevojave në këtë fakultet janë vendosur edhe tre videoprojektore nëpër klasa. Referuar gjendjes së ambjenteve në kuadër të ristrukturimit është bërë edhe mobilimi i tyre e cila për vitin 2018-2019 arriti në shumën e investimit 5.539,200 lekë.

Të gjitha klasat janë të pajisur me kondicionerë duke siguruar kushte të mira të studentëve gjatë procesit mësimor. Në total UV për vitin 2017-2018 ka blerë 30 kondicionerë ku Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore ka përfituar 14 copë me një shumë totale investimi 1.803,720 lekë. Referuar numrit të studentëve dhe kapaciteve të infrastrukturës së godinës si edhe fashave orare të programeve të studimit që ofrohet konkludojmë që FSHTN ofron një normativë të pritshme prej 4.7m²/student.

[Ev. raport vjetor UV 2018-2019; Ev. Plotësimi i rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm; Ev. Infrastruktura e godines C].

Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise

GVJ konstatoi që klasat, laboratorët ku zhvillohet programi i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" janë të pajisura në përputhje




<p>të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>me standardet që kërkon një zhvillim i drejtë dhe bashkëkohor i procesit të mësimdhënies. Procesi mësimor zhvillohet në 8 salla leksioni dhe seminari duke përbërë në mënyrë të mjaftueshme kapacitetin prej 27 studentë të këtij program studimi. Në funksion të programit të studimit janë vënë 2 laboratorë secili i pajisur me 20 terminale, një server, dhe një videoprojektor për zhvillimin e mësimin. Laboratori 402 është edhe klasa e cila për Godinën C në FSHTN është e pajisur edhe me tabelë elektronike. Laboratorët kanë akses në internet dhe janë të pajisur me të gjithë software-t e duhur për të mundësuar asimilimin e kuadrit teorik në praktikë.</p> <p><i>[Ev. raport vjetor UV 2018-2019; Ev. Plotësimi i rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm; Ev.Infrastruktura e godines C]</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” përdoren 2 laboratorë (konkretisht C302 dhe C402) me sipërfaqje secili 50m² të vendosur në Godinën C <i>[Ev.Infrastruktura e godines C]</i>. Këto laboratorë janë të pajisur me të gjithë softuer-ët e nevojshëm. Laboratorët shfrytëzohen edhe për programe të tjerë studimi, por është mirëllogaritur fasha e orareve të programeve tëstudimit duke mundësuar që studentët në këtë program të zhvillojnë veçmas studimin pa u bashkuar në orët laboratorike me studentë të programeve të tjera të studimit. Laboratorët në oraret që janë të lira janë disponibel për studentët të cilët shprehin interesin të zhvillojnë orë shtesë laboratorike. Për mbarëvajtjen e orëve laboratorike është vënë në dispozicion një laborant nga stafi akademik, ndërsa personeli nga Sektori IT është në dispozicion për mirëmbajtjen e tyre.</p> <p><i>[Ev. Raport vjetor UV 2018-2019; Ev. Plotësimi i rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm; Ev.Infrastruktura e godinës C].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike zotëron 2 laboratorë të informatikës të pajisur me softet e duhura për zhvillimin e lëndëve. Laboratorët janë të pajisur me të gjithë mjete didaktike për zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p><i>[Ev. Raport vjetor UV 2018-2019; Ev. Plotësimi i rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm; Ev.Infrastruktura e godinës C].</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” nuk zhvillohet praktikë profesionale, ndonëse kërkesa për të u paraqit gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik dhe është paraqitur nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike edhe në praktikën e dorëzuar në MASR për riorganizimin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” datë 23.07.2018 me nr. 945/5prot. duke shtuar në semestrin e gjashtë lëndën CS 390 Praktikë Profesionale me një peshë 6 kredite.</p>

	[Ev. Praktikë e dorëzuar në MASR për riorganizimin e programit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sektori i Bibliotekës Shkencore është njësi ndihmëse e Universitetit, strukturë ndihmës – akademike me karakter administrativ dhe në nivel institucioni ndodhet në varësi të Rektorit.</p> <p>Në UV janë vënë në dispozicion tre biblioteka përkatesisht në godinën A, B dhe godinën C ku ndodhet edhe Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore në të cilin zhvillohet edhe programi i studimit. Në Bibliotekë angazhohen 4 specialistë përkatesisht 2 për Bibliotekën A, 1 specialistë për godinën B dhe 1 specialistë për bibliotekën në godinën C. Biblioteka në godinën C është e re dhe e ristruktuar në kuadër të punës që UV ka bërë në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të dhëna nga Bordi i Akreditimit [Ev. Plotësimi i rekomandimeve të mëparshme], si edhe në përmbushje të kërkesës së bërë nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Koeficienti i shfryzueshmërisë që llogaritet me numrin e përdoruesve në bibliotekë dhe numrin e vendeve në çdo sallë është afërsisht 67%. Sipërfaqja e bibliotekës A është 252m², sipërfaqja e bibliotekës B është 90m² ndërsa e bibliotekës në godinën C është 80m².</p> <p>Pasurimi i fondeve të bibliotekës sigurohet përgjithësisht me fonde të institucionit përmes blerjeve me procedurë të kufizuar sipas buxhetit të përcaktuar me preventivat dhe specifikimet teknike të dhëna nga Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore dhe departamentet përkatese si edhe nga donacione nga institucione shtetërore, organizata jofitimprurëse.</p> <p>Bibliotekat janë të strukturara mirë dhe të pajisura me të gjithë elementet që mundësojnë sigurimin e një komoditeti të duhur për studentët dhe pedagogët. Biblioteka A ka një kapacitet 60 vende studimi në sallë, Biblioteka B – 37 vende dhe Biblioteka C – 23 vende. GVJ bëri një tur online ku pa edhe ambjentet e bibliotekës në godinën C. Ky tur u shoqërua nga specialisti në këtë bibliotekë i cili paraqiti edhe ambjentet e brendshme dhe dha shpjegimet e duhura në</p>



	<p>lidhje me pasurimin e bibliotekës, mënyrës së katalogimit të librave dhe numrin e përdoruesve. Biblioteka qendrore në Godinën A është e hapur nga dita e Hënë –Premte, ora 08:00 -20.00 dhe është në funksion të studentëve, pedagogëve dhe stafit akademik të Fakultetit të Ekonomisëdhe Rektoratit, ndërsa mbasdite është në shërbim edhe për studentët e fakulteteve të tjera. 2 bibliotekat përkatësisht në Godinën B dhe C janë të hapura nga dita e Hënë – e Premte, orari 08.00-16.00 (me fundjavë dhe ditë festash pushim). Bibiloteka ka përgatitur edhe rregulloren e brendshme të saj në pritje të miratimit nga Senati Akademik.</p> <p><i>[Ev. Plotësimi i rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm; Ev.Informacion i sektorit të Bibliotekës Shkencore në funksion të akreditimit të programeve].</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka në tre godinat është e pasuruar me literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj. Biblioteka në Godinën C është në shërbim të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore ku bën pjesë edhe programi i studimit i marrë në shqyrtim. Pasurimi i bibliotekës bëhet përmes procedurave të parashikuara në Rregulloren e e FSHT-së dhe të UV-së. Në total fondi i trashëguar në te tre bibliotekat për periudhën 1994-2016 është 35,000 tekste në kopje (copë) për rreth 15,000 tituj, ngatë cilat blerje janë 29,730 kopje për 10,833 tituj, ku për bibliotekën C nuk kemi të dhëna pasi është e re dhe e ristrukturuar ne 28.03.2018.</p> <p>Për vitin akademik 2016-2017 është bërë pasurimi i bibliotekës në total me 408 tituj nga të cilat 231 janë në gjuhën shqipe dhe 177 në gjuhën angleze me 4160 vëllime në total.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore është bërë pasurimi me 136 tituj (33%) nga këto 44 (24.8%) në anglisht, 92 shqip (39.8%) me 673 vëllime në gjuhën shqipe, 55 vëllime në gjuhën angleze dhe në total arrijnë 728 vëllime (17.5%); <p>Për vitin akademik 2017-2018 koleksionii bibliotekës është pasuruar në total me 160 tituj, nga të cilët 71 në shqip, 89 në anglisht, në 3224 vëllime nga të cilat 3120 vëllime në shqip dhe 104 në anglisht.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore ka përfituar në këtë proces pasurimi 100 tituj (62.5%), nga këto 52 anglisht (58.4%), 48 shqip (67.6%) me 447 vëllime në gjuhën shqipe (14.3%) dhe 54 vëllime në gjuhën angleze (60.6%), totali 501 vëllime (16%); <p>Për vitin akademik 2018-2019 është bërë blerje e posaçme për literaturë në gjuhë të huaj (anglisht) posaçërisht për Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore që kap shifrën 800,00 lekë pa</p>



	TVSH e realizuar kjo në datë 14.01.2020 [Ev. Informacion i sektorit të Bibliotekës Shkencore në funksion të akreditimit të programeve].
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Me Vendimin nr.83 datë 18.07.2017 të Senatit Akademik është miratuar në parim regjistrimi i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë në një bibliotekë dixhitale. [Ev. Vendim i Senatit Akademik të UV Nr. 83, datë 18.07.2017 “Për miratimin në parim të regjistrimit të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, në një bibliotekë on-line”]</p> <p>Për dixhitalizimin e katalogut bibliografik të koleksionit të Bibliotekës përdoret softueri Cobib.al si pjesë e rrjetit në sistemin ndërkombëtar Cobis.net. Studentët mund të kërkojnë material/ tectse sipas manualit të librarisë dixhitale e cila ndihmon në aksesimin e shërbimit në linkun https://ulibrary.rash.al. Për dixhitalizimin e standartizuar dhe të unifikuar të librit/ tekstit mësimor apo artikujve shkencorë të nevojshëm po bëhen përpjekje unifikimi me rrjetin e Bibliotekave Universitare me lider Bibliotekën e Akademisë së Shkencave.</p> <p>Për Bibliotekën online është punuar me burime elektronike për Shqipërinë [Electronic Resources for Albania (ERA 2021 Project)] mbështetur nga IZUM/Qendra Rajonale për Sistemet e Informimit Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor www.cobis.net; EIFL/Informacin Elektronik për biblioteka www.eifi.net dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë www.akad.edu.al/era ku studentët dhe pedagogët kanë akses në informacion me tekst të plotë nga ebrary Academic Complete, EBSCO Academic Research Premier, Emerald Management & Journal Collection, Multi-Science Journals Collection, ProQuest Central, Taylor & Francis library etj</p> <p>Janë rregjistruar në programin Cobiss sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online për gjithë artikujt shkencorë të pedagogëve të UV-së, të autorëve të tjerë shqiptare dhe të huaj të cilat janë botuar në:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Buletinet Shkencore të UV-së nga viti 2013 – në vazhdim) me ISSN 2310-6719; b) Buletinet Shkencore të UV-së nga viti 2001 – 2008), gjithsej 13 buletine pa ISSN të cilëve iu është vënë numri i brendshëm Y990-80810 përcaktuar nga Cobiss dhe e njohur ndërkombëtarisht. <p>[Ev. Informacion i sektorit të Bibliotekës Shkencore në funksion të akreditimit të programeve]</p> <p>[Ev- Informacion i sektorit të Bibliotekës Shkencore në funksion të akreditimit të programeve].</p>

<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Bibliotekat në të tre godinat janë të pajisura me kompjutera dhe projektor. Biblioteka në Godinën C është e pajisur me 4 kompjutera dhe 1 projektor.</p> <p><i>[Ev. Informacion i sektorit të Bibliotekës Shkencore në funksion të akreditimit të programeve].</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>GVJ konstaton që UV ndjek një politikë të qartë në lidhje me pasurimin e fondit të bibliotekës. Nga të dhënat e përmendura më sipër konstatohet që kemi një rritje të pasurimit të zërave të bibliotekës për periudhën 2018-2019 kundrejt periudhës 2017-2018.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka qendrore në Godinën A është e hapur nga dita e Hënë – e Premte, ora 08:00 -20.00 dhe është në funksion të studentëve, pedagogëve dhe stafit akademik, ndërsa mbasdite është në shërbim edhe për studentët e fakulteteve të tjera. 2 bibliotekat, përkatësisht në Godinën B dhe C janë të hapura nga dita e Hënë – e Premte, orari 08.00-16.00 (me fundjavë dhe ditë festash pushim).</p> <p><i>[Ev. Informacion i sektorit të Bibliotekës Shkencore në funksion të akreditimit të programeve].</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Jo e përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë ka ngritur në çdo department dhe fakultet sekretariatë mësimore. Mbajtja dhe ruajtja e të dhënave bëhet mbi bazen e përcaktimeve ligjore tëshprehur në Statut <i>[Ev. Statuti i UV-së , neni 12; Ev. Rregullore të UV-së e ndryshuar neni 54 dhe 55]</i> si edhe mbi bazën e vendimeve të marra nga Senati Akademik në lidhje me menaxhimin e sistemeve tëinformacionit brenda Institucionit.</p> <p>Sekretariatë mësimore të fakulteve dhe departamenteve mbajnë rregjistër bazë të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomat e marrë së bashku me suplementin përkatës dhe të formatuar sipas standarteve shtetërore <i>[Ev. Model diplome; Suplementi i diplomës]</i></p>

	<p>Bachelor në Shkenca Kompjuterike]. Mbjajta dhe ruajtja e të dhënave bazohet në Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Regjistri themeltar i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe ruhet në formë të përhershme. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për përpilimin, administrimin dhe mirëmbajtjen rregjistrimit themeltar (bazë) i cili plotësohet me shkrim dhe pa korrigjime dhe nuk ndryshohet. <i>[Ev. Pjesë nga regjistri themeltar i studentëve].</i></p> <p>Në sekretarinë mësimore depozitohen të firmosura nga personeli akademik lista e studentëve të regjistruar në kurs e ndarë me leksione dhe seminare, me informacion për mungesat dhe proçes – verbalet e vlerësimeve në provime të pjesshme dhe përfundimtare si edhe çdo informacion i konfirmuar për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe i firmosur nga përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Kompjuterike. Çdo student me rregjistrimin fillestar i jepet një numër unik matkulimi që e shoqëron atë deri në marrjen e diplomës duke respektuar në këtë mënyrë ligjet në fuqi. Sekretaritë janë përgjegjëse edhe për plotësimin e rregjistrimit të lëshimit të diplomave. Plotësimi i tyre bëhet me shkrim dhe në formë elektronike. Në mbështetje të punës së sekretarisë mësimore është edhe Drejtoria e Komunimit dhe Burimeve Njerëzore, sektori IT; Ky sektor është përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit universitar UVMS i cili u krijua pas vendimit Nr.101 datë 06.12.2017 për krijimin dhe funksionimin në UV të platformës digjitale me akronimin UVMS (University of Vlora Management System) (https://uvms.univlora.edu.al).</p> <p>Kjo platformë mundëson shërbim dhe akses të studentëve dhe stafit akademik. UV ka vënë në dispozicion edhe 2 Manuale përdorimi përkatësisht për studentët dhe stafin akademik përdorues të kësaj platforme. <i>[Ev.Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit].</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Platforma UVMS nuk mundëson një administrim në tërësi të të gjithë informacionit në UV. Për menaxhimin e informacionit të brendshëm janë përgjegjëse edhe strukturat administrative të ngritura në këtë Institucion.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore</u> është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave në lidhje me personelit akademik, ndihmës- akademik, personelin akademik të ftuar si edhe me procedurat dhe raportimet përkatëse të kërkuara nga hallkat brenda institucionit dhe jashtë tij. • <u>Spektori i Arshivës – Protokollitështë</u> përgjegjës për ruajtjen dhe arshivimin e dokumentacionit bazë;

	<ul style="list-style-type: none"> • <u>Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional</u> është përgjegjëse për menaxhimin e informacionit të marrë nga fakultetet dhe departamentet pjesë përbërëse e tyre në lidhje me sigurimin e cilësisë dhe garantimin e qëndrueshmërisë së saj; • <u>Spektori i Promovimit Akademik dhe Botimeve Shkencore</u> është përgjegjës për administrimin e progresit të stafit akademik në drejtim të fushës kërkimore shkencore dhe pjesëmarrjes në projekte, trajnime dhe seminare brenda dhe jashtë vendit; <p>Mbajtja e të dhënave bëhet me shkrim dhe në formë elektronike. [Ev.Statuti i UV-së ; Ev.Rregullore UV-së e ndryshuar]</p>				
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UVMS garanton një menaxhim të informacionit për të gjithë personelin, studentët dhe stafin akademik. Aksesin në këtë platformë e kanë të gjithë hallkat pjesë përbërëse të sistemit të menaxhimit të procesit të mësimdhënies. Përmendim këtu: studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore, Përgjegjës të Departamentit të Shkencave Kompjuterike; zyra e IT-së në Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore [Ev.Statuti i UV-së ; Ev.Rregullore UV-së e ndryshuar]				
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore përdor një sistem të menaxhimit të informacionit UVMS ku hidhen, ruhen dhe përpunohen të dhënat në lidhje me vlerësimin e studentëve. Sistemi UVMS ofron mundësi të kufizuara komunikimi interaktiv ndërmjet personelit dhe studentëve. [Ev.Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit].				
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi UVMS garanton një përgjigje në kohë reale të aktivitetit akademik. Sistemi mundëson përpunime statistikore në lidhje me studentin, progresin e tij, detyrimet që ai mbart. Sistemi UVMS mundëson edhe një përpunim statistikor të pyetsorëve të studentëve në sondazhet që kryhen. [Ev.Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit].				
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacioni bazë dhe ndihmës për universitetin, programet mësimore që ofrohen, kuadrin ligjor, stafin akademik, oraret mësimore, regjistrimet, tarifat, projektet kërkimore shkencore, bursat, njoftimet dhe aktivitetet sociale janë të reflektuar në faqen web https://univlora.edu.al/ .				
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Struktura e hartimit të buxhetit të UV-së, shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre bëhet në përputhje dhe sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave (Udhëzimi nr.2 datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarte të Buxhetit”; Udhëzimit nr.677 datë 16.01.2015 i Ministrit të Financave, për një shtesë dhe një ndryshim në Udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012) [Ev. Plani strategjik 2018-2024].</p> <p>Administratori i Universitetit është përgjegjës për hartimin e projektbuxhetit vjetor mbi bazën e propozimeve të njësisë bazë dhe kryesore [Ev.Statuti i UV-së, neni 40]. Në UV vepron edhe Administratorët në Fakultete të cilat janë përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të Fakultetit. Senati Akademik i UV-së analizon dhe vlerëson efikasitetin dhe mënyrën e hartimit, përdorimit dhe realizimit të buxhetit, performancën e strukturave financiare dhe administrative në funksion të shërbimeve për studentët, personelin akademik dhe ndihmës – akademik. Rektori, Senati Akademik dhe Asambleja e personelit akademik brenda kompetencave të tyre propozojnë kërkesat për t’u marrë në konsideratë gjatë hartimit të buxhetit [Ev.Statuti i UV-së, neni 27, 34; Ev.Rregullore UV-së e ndryshuar].</p> <p>Rektori dhe Senati Akademik në bashkëpunim me Bordin e Administrimit përpunojnë dhe shpallin treguesit për të verifikuar objektivat e vendosura, rezultatet e arritura dhe kostot përkatëse. [Ev.Statuti i UV-së, neni 5].</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në</p>	<p>Bordi i Administrimit është organi më i lartë Kolegjial administrativ i UV-së i cili garanton mbarëvajtje financiare dhe administrative të tij. Detyrat e tij janë të përcaktuara në Statut dhe në Rregullore të UV-së. [Ev.Statuti i UV-së, neni 23, 24]. Me propozim të Senatit Akademik ai miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm si edhe garanton zbatimin e tij. Ai përcakton edhe rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që sigurohen nga ushtrimi i veprimtarisë si edhe mbikqyr përdorimin e burimeve të financimit. Në varësi të administratorit është Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse e cila përbëhet nga sektorët:</p>

<p>bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>a. Sektori i Financës dhe realizimit të Buxhetit; b. Sektori i Prokurimeve; c. Sektori i Shërbimeve ;</p> <p>Në varësi të Bordit të Administrimit është Sektori i Auditit [Ev.Statuti i UV-së, neni 27, 34; Ev.Rregullore UV-së e ndryshuar].</p> <p>Për vitin 2017 ka pasur një rritje të të ardhurave në masën 29% më shumë se në vitin 2016. Nga ky total 49% e fondeve kanë qënë shpenzime personeli, 11% blerje të materialeve dhe shërbimeve, 19% fonde për investime kapitale (përfshirë organizimi, pjesëmarje në konferenca dhe për botim artikujsh) dhe pjesa tjetër e mbetur janë përdorur për të bërë likuidimet e procedurave të mbetura nga viti 2016 [Ev. Plani strategjik 2018-2024].</p> <p>Financimet për vitin 2018 janë bazuar në grante për shpenzime korente dhe transferta dhe të ardhurat nga institucioni. Të ardhurat janë nga qerata, tarifë shkollimi Bachelor dhe Master, vërtetime etj. Shpërndarja është bërë në studim projekte, investime, paga dhe shpërblime, shpenzime operative, transferta jashtë dhe tek individë ku në këtë të fundit konsiderohen edhe bursat e studentëve. Për vitin 2018 është rikonstruktuar godina B, janë blerë pajisje elektronike ku Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore ka përfituar 18,636,966 leke, mobilimi i ambjenteve dhe zyrave në vlerën 5,539,200 leke, FV kondicionerë (14 copë) me vlere totale 1,803,720 leke. Evidentojmë një rritje të të ardhurave në vite. Për vitin 2016 9% e të ardhurave kanë mbuluar fondin e pagave, 18% për vitin 2017 dhe 20% kanë mbuluar për vitin 2018 dhe 23% për vitin 2019.</p> <p>[Ev. Raporti vjetor i UV për vitin 2017-2018; Ev. Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>UV i nënshtrohet një sistem auditimi të brendshëm dhe të jashtëm. Auditimi i brendshëm kryhet nga Sektori i Auditit që ndodhet në varësi të Bordit të Administrimit [Ev.Statuti i UV-së] ;</p> <p>Duke konsideruar si strukturë publike ajo i nënshtrohet edhe auditimit nga MASR dhe Institucioneve si Kontrolli i Lartë i Shtetit.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin</p>	<p>Në mbyllje të çdo cikli studimi UV dokumenton edhe raportet financiare të tre viteve të fundit dhe bën planifikimet për ndërhyrje të posaçme bazuar edhe në strategjinë afatmesem të tij. [Ev.Statuti i UV-së].</p>

eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.				
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	UV dhe vetë program i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera garantojnë stabilitetin financiar të këtij program studimi ndonëse në raportet financiare nuk jepet qartë impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit. [Ev. Raporti vjetor i UV për vitin 2017-2018; Ev. Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UV ka të sanksionuara të gjithë procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve në programin Bachelor “Shkenca Kompjuterike”. Këto procedura janë të shprehur qartë në Statutin e UV-së Kreu VII, në Rregulloren e UV-së, në Rregulloren e FSHTN-së, në Rregulloren e DSHK-së, në “Rregulloren e Funkcionimit dhe Pranimit të Kandidatëve në Programin Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”, në vendimin e Senatit Akademeik për pragun e notës, në Procedurat për Transferimin e Studentëve, në procedurën e Ankimimit, Rregulloren e Diplomimit të Studentëve në FSHTN. UV synon në zbatimin me rigorozitet të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit

	të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në udhëzimet e MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019.
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>DSHK ndjek politika dhe procedura të mirëpërcaktuara që garantojnë barazinë tek çdo student në këtë program studimi. Statuti dhe rregulloret institucionale garantojnë mundësi të barabarta për kushtet materiale dhe financim të mësimdhënies si edhe kërkimit shkencor. Mbështetja për diferencime individuale është përjashtim që lejohet nga organet kompetente sipas mënyrës së përcaktuar në ligj apo në akte nënligjore në fuqi. Procedurat e ndjekura janë në akordancë edhe me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore në fuqi të kërkuara edhe nga MASR. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese që veprojnë sipas hierarkisë, me kompetenca të përcaktuara në ligjin e Arsimit të Lartë, në rregullore dhe në aktet e brendshme vetregulluese të institucionit.</p> <p>Procedurat e pranimit, të studimit, të transferimit, i gjejmë të shprehur në Rregulloren e Programit të Studimit. Ato janë të pasqyruar në website të UV-së, në fletëpalosje etj Përfundimi dhe vlerësimi i studimeve bëhet konform rregullores së programit të studimit dhe pajisja e studentit me diplomë miratohet nga Senati Akademik në përputhje me udhëzimet sipas ligjit.</p> <p><i>[Ev.Statuti i UV-së neni 3dhe 4; Ev.Rregullore e Fakultetit te Shkencave Teknike; Ev.Rregullore e Departamentit te Shkencave Kompjuterike; Ev.Procedura e Pranimit në Ciklin e Parë të Studimit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; Ev.Procedura e Transferimit në Ciklin e Parë të Studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike; Ev. Fletëpalosje].</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” realizohet bazuar në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, Rregulloren e UV-së, Statuti i UV-së dhe drejtohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike si njësi bazë e këtij fakulteti. Rregjistrimet e studentëve në këtë program studimi kryhen nga Sekretaria Mësimore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike në Fakultetin e Shkencave Teknike (FSHTN). Tarifa e regjistrimit të kandidatëve është sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullave të miratuara nga FSHTN dhe UV. Afati i studimeve për këtë cikël studimi është i përcaktuar në ligjin Nr.80/2015 datë 22.07.2015. Leksionet zhvillohen sipas orarit mësimor të aprovuar nga Dekanati i FSHT-së. Orari shpallet përpara semestrit në website të universitetit dhe i bëhet i qartë edhe studentit. Orari është i detajuar dhe përcakton sallën e zhvillimit të leksionit apo seminarit, kohën dhe ditët e zhvillimit si edhe pedagogun e lëndës. Orari</p>

	<p>mësimor ndërtohet mbi bazën e harmonizimit të elementëve të mësimit dhe të shpërndarjes racionale të ngarkesës së studentit. Ngarkesa luhatet në 20-25 orë në javë.</p> <p><i>[Ev.Kalendari Akademik 2019-2020].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se kriteret e pranimit, procedurat e përzgjedhjes së studentëve janë zbatuar me rigorizitet nga njësia bazë për këtë program studimi. Kriteret e pranimit janë të theksuara në Statut dhe në Rregulloren e FSHTN-së, Rregulloren e DSHK-së, Rregulloren e Funkcionimit dhe Pranimit të Kandidatëve në programin mësimor Bachelor në “Shkencë Kompjuterike”. Pranimi i kandidatëve të rinj në programin e studimit bëhet sipas listave të miratura nga MASR <i>[Ev. Rregullore UV-së e ndryshuar, neni 39]</i>. Senati Akademik ka të drejtën të përcaktojë kriteret shtesë për pranimet në ciklin e parë të studimeve Vendimi Nr. 19 dat 19.04.2018, ka përcaktuar edhe kriteret e veçanta të pranimit për kandidatët e rinj në programin e studimit për vitin akademik 2019-2020 ku theksohet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Renditja e maturanteve kandidatë do të bëhet në bazë të mesatares së shkolles së mesme;</i> 2. <i>Ndër kandidatët me pikë të barabarta përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Informatike në tre vitet e studimit të shkolles së mesme;</i> <p>Këto kritere të miratuara përcillen në QSHA dhe në Ministrinë e Arsimit, Rinise dhe Sporteve për miratim.</p> <p>Kuotat dhe kriteret e pranimit propozohen nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe miratohen nga Senati Akademik. Për vitin akademik 2019-2010 përmes Vendimit Nr.8 datë 07.02.2019 janë miratuar për këtë program studimi 50 kuota mbi bazën e kapacitetit pritës ku brenda vendit janë 40, me statusin e personit me aftësi të kufizuar është 1, me statusin e jetimit 2, kandidatë romë dhe ballkano egjiptianë 1, transferim studimesh 3 dhe program të dytë studimi 3. GVJ konstatoi edhe një rënie të numrit të kuotave për këtë program studimi. Për vitin akademik 2018-2019 numri i kuotave ishte 70. Ndjekja e një program të dytë studimi është e përcaktuar në Nenin 66 në Statutin e UV-së. Individët që kanë përfunduar një program studimi kanë të drejtën të ndjekin një program të dytë studimi në të njëjtin cikël. Në këtë rast përzgjidhet kandidati që ka mesataren më të lartë. Kriteret specifike për ndjekjen e një programi të dytë përcaktohen nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Për vitin 2018 – 2019 rezultojnë 2 studentë të transferuar dhe nuk ka raste të studentëve të regjistruar në program të dytë. GVJ konstatoi edhe praktika të zhvilluar për vitin akademik 2018-2019 për transferim të studentëve. Nga evidencat rezultojnë tre kandidatë të cileve u njihet nga komisioni njohja e lëndëve dhe</p>



	<p>shpallja fitues. <i>[Ev. Procedura e Transferimit në Ciklin e Parë të Studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike]</i></p> <p>GVJ evidentoi praktika të drejta në lidhje me pranimet e studentëve në të dy raundet e aplikimit, për përlogaritjen e pikëve për çdo konkurrent dhe hartimin e listave të kandidateve fitues mbi bazën e pikëve të grumbulluara për vitin akademik 2019-2020. Pranë Departamentit të Shkencave Kompjuterike është ngritur për vitin akademik 2019-2020 edhe një komision i posaçëm i përbërë nga përgjegjësi i departamentit, tre anëtarë nga stafi akademik, përfaqësues të Sektorit të IT-së dhe përfaqësues nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës të cilët në funksion të punës së tyre kanë hartimin e listës fituese në bazë të pikëve të grumbulluara nga kandidatët në raundin e parë dhe të dytë referuar kriterëve të përcaktuara nga MASR për pranimin në këtë program studimi. Në bazë të nenit 25 pika 8 e ligjit 80/2015, është departamenti përgjegjës për përzgjedhjen e studenteve fitues. Lista e plotë dhe proces verbalet e plota të gjithë hallkave të procedurës së ndjekur për renditjen e tyre përcillet tek Dekani i FSHTN-së. Dokumentacioni hartohet në 4 (katër) kopje origjinale (hard copy) ku njëra prej tyre i përcillet Rektorit për miratim pas verifikimit të listës përfundimtare nga ana e Dekanatit të FSHTN-së. Lista e miratuar publikohet edhe në website të UV-së.</p> <p><i>[Ev. Procedura e Pranimit në Ciklin e Parë të Studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike].</i></p> <p><i>[Ev. Procedura e Pranimit në Ciklin e Parë të Studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike]</i></p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe specifike janë të hartuara në përputhje me aktet ligjore në fuqi, në zbatim të VKM –së nr.295 datë 10.05.2019, Udhëzimit të MASR Nr. 10 datë 15.05.2019. Për vitin akademik 2019 – 2020 nuk është parashikuar vendosja e kriterit të pranimit të studentëve të huaj. Bazuar edhe në Strategjinë e Zhvillimit synohet që për vitin akademik 2020-2021 të futen në kuota edhe studentë që vijnë nga trojet kryesisht nga Kosova, Maqedoni, Mal i Zi.</p> <p><i>[Ev. takim me Përgjegjësen e Departamentit të Shkencave Kompjuterike].</i></p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike ndjek një politikë sensibilimi dhe informimi në lidhje me programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”. Në website publikon të gjithë informacionin informues në lidhje me programet e studimit, përmbajtjen e lëndëve dhe syllabuset përkatëse. Në bashkëpunim me Sektorin e Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe Aktivitetëve</p>

	Kulturore Sportive zhvillon takime informuese të cilat finalizohen me aktivitetin "Open Day". <i>[Ev. Open day; Ev. Informimi i studentëve të rinj; Ev. Aktivitete për promovimin e UV Informimi i maturantëve; Ev. Fletëpalosje e FSHTJ].</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" realizohet me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja akademike është 3 vjet. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite. Në këtë program studimi nuk ofrohet praktikë profesionale <i>[Ev. Statuti i UV-së neni 57].</i></p> <p>Të gjithë të drejtat dhe detyrimet që studenti duhet të plotësojë gjatë periudhës së studimit janë të përcaktuar qartë në Statut, Rregullore të UV-së, Rregullore të FSHTN-së, Rregullore të DSHK-së dhe në Rregulloret specifike të pranimit, transferimit. Që në fillim të vitit akademik studentët njihen me të drejtat dhe detyrimet e tyre. Për çdo lëndë stafi akademik vë në dispozicion të studentit syllabuset ku jepet qartë përmbajtja e lëndës dhe detyrimet përkatëse që studenti duhet të plotësojë. Syllabuset publikohen edhe në website të UV-së. Sekretaria mësimore pranë DSHK-së është në dispozicion të studentëve duke ofruar shërbim në lidhje me regjistrimin, paraqitjen e notave dhe ndihmën për dokumentacionin që studenti duhet të paraqesë që në momentin e pranimit të tij në këtë program studimi. Ajo mirë administron edhe proces verbalet e paraqitura nga stafi akademik për çdo provim të kryer. Sistemi UVMS mundëson edhe një akses të studentëve në lidhje me rezultatet e provimeve, procedurat e regjistrimit të tyre në provime. Progresi i studentëve mbështetet nga DSHK dhe nga tutoriati i ngritur në këtë departament. GVJ konstatoi zhvillimin e një praktikë të drejtë të tij në këtë e cili u pranua si efektive edhe nga vetë studentët gjatë takimit të zhvilluar. <i>[Ev. Këshilltari akademik]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje</p>	<p>Universiteti u ofron studentëve mundësi njohje të krediteve dhe transferimin e studenteve midis programeve të të njëjtit cikël studimi</p>

me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.

brenda vetë universitetit apo insitucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Këto transferime lejohen brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe kryhet vetëm në fillim të vitit akademik. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në Rregulloren e Universitetit [Ev.Statuti i UV-së neni 68]. GVJ u njoh me praktikë të transferimit e cila ishte zhvilluar konform Rregullores dhe Statutit të UV-së. [Ev. Procedura e Transferimit në Ciklin e Parë të Studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”]

Tabela e numrit të studentëve nga sekretaria mësimore

Viti Akademik	Te regjistruar për here të parë	Nota mesatare në hyrje	Student të transferuar
2016-2017	34	7.49	-
2017-2018	23	7.19	2st/viti I
2018-2019	17	7.60	1 st/viti I 1 st/viti II
2019-2020	30	7.76	-
2020-2021	27	7.92	1 st/viti I 1 st/viti II

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.

Në UV Vlorë shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjete notash. Në listën e notave që shoqërojnë diplomën pasqyrohen vetëm nota përfudimtare kaluese. Mesatarja e studentit llogaritet si mesatare e ponderuar. Ceremonia e diplomimit zhvillohet për të gjithë fakultetet në shkallë universiteti dhe drejtohet nga Rektori në prani të përfaqësuesve të Senatit Akademik, profesoratis, administratës dhe studentëve. [Ev.Statuti i UV-së neni 68].

Vlerësimi i dijeve është i përcaktuar qartë në Rregullore të FSHTN-së, në Rregullore të DSHK-së dhe në çdo syllabus të programit të studimit. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentëve përcaktohen në programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve. Vlerësimi në një lëndë bëhet :

1. Me provim me shkrim;
2. Me detyra kursi ose projekte kursi;
3. I bazuar në kombinime formash;


Në fillim të çdo semestri akademik studenti informohet në lidhje me kriteret e vlerësimit të tij të cilat janë të shprehur edhe në syllabuse.

	<p>Nga takimi me studentët u konstatua informimi i tyre në lidhje me provimet e pjesshme, detyrën/projektin e kursit dhe provimin final. Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive realizohet gjatë gjithë vitit dhe mbyllet me provimin përfundimtar, pesha e të cilit në vlerësimin e përgjithshëm është 60% deri 65%. Elementët e tjerë që merren në konsideratë gjatë vlerësimit të lëndës janë provimi i pjesshëm (me një peshë që varion nga 20% në 25%) dhe vlerësimi që lidhet me detyrimet e tjera të lëndës siç janë laboratorët, seminarët dhe detyra e kursit (me një peshë që varion nga 10% në 20%).</p> <p>Studenti ka të drejtën e ankimit për rezultatin përfundimtar të provimit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni të vlerësimit. Ai paraqet edhe kërkesë në Departamentin e Shkencave Kompjuterike. Ankesa shqyrtohet nga Dekani i FSHTN-së i cili menjëherë ngre edhe komision ad-hoc që bën verifikimin e pretendimeve të studentit. GVJ u informua gjatë takimit si edhe në DVD me praktikë ankimi në këtë program studimi dhe konstaton zbatimin e drejtë të procedurës konform Rregullores në fuqi në UV dhe Rregullores së FSHTN. <i>[Ev.Procedurë ankimi në departament]</i>.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Fakulteti ka përgatitur edhe Rregullore të diplomimit e cila u vihet në dispozicion studentëve dhe është e pasqyruar edhe në Website të UV-së.</p> <p>Studentët kanë të drejtën në përfundim të kursit të plotë të diplomohen. Kjo është e shprehur në Statut dhe në Rregullore të FSHTN -së (neni 28). Sekretaria mësimore përcjell përmes një shkrese të veçante tek përgjegjësi i departamentit dhe Dekani i FSHTN-së listën e studentëve që plotesojnë detyrimet e një program studimi dhe detyrimet financiare dhe që kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës. Përgjegjësi i departamentit përmes një komisioni ad-hoc bën edhe verifikimin e listës së studentëve. Pragu i notës mesatare për zhvillimin e punimit të diplomës përcaktohet në Rregulloren e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe ndryshohet me vendim të Senatit Akademik <i>[Ev.Statuti i UV-së neni 57]</i>. Në Rregullore të FSHTN-së është përcaktuar se pragu i notës mesatare që i jep studentit të drejtën të diplomohet është nota mesatare 9 (nëntë). Ndryshimi i këtij kriteri bëhet me miratim të Senatit Akademik. Vendimi i Senatit Akdemik nr. 09 datë 26.01.2017 ka përcaktuar që për ciklin e parë të studimeve nota mesatare 9 (nëntë) të jetë edhe pragu i notës mesatare për diplomim të studentit <i>[Ev.Vendim i Senatit Akademik të UV, nr.9 datë 26.01.2017 Për miratimin e pragut të notës]</i>.</p> <p>Në përfundim të studimeve për marrjen e diplomës parashikohet përgatitja e një teze diplome e cila hartohet në përputhje me rregulloren e punimit të diplomave në FSHTN. Mbrojtja e saj bëhet</p>

	<p>e hapur. Në përfundim të studimit studenti pajisjet me diplomën e lëshuar nga UV së bashku me suplementin e diplomës. Ky i fundit hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë [Ev.Statuti i UV-së, neni 71 statut; Ev. Model diplome; Suplementi i diplomës Bachelor në Shkenca Kompjuterike; Ev. Rregullore e diplomimit në FSHT].</p> <p>GVJ konstatoi formatin e suplementit të diplomës dhe pranon që ajo është sipas standarteve të kërkuara në fuqi. Tërheqja e diplomës bëhet nga studenti personalisht kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në rregjistrin përkatës. Dorëzimi i diplomës bëhet me një ceremoni të veçantë të organizuar nga UV për të gjithë fakultetet. Për studentët të cilët nuk kalojnë pragun e notës mesatare për diplomë iu nënshtrohen procedurës së diplomimit përmes provimit [Ev. Procedura e diplomimit përmes provimit]. GVJ gjatë takimeve të zhvilluara me studentët dhe stafin akademik konstatoi që studentët ishin në dijeni në lidhje me këtë procedurë [Ev.Takim me studentët]. Praktika e paraqitur në DVV tregon edhe zbatimin korrekt të tezës së provimit. Kjo tezë përmban në total 50 pyetje nga tre lëndet përkatësisht: Arkitekturë Kompjuteri, Sistemet e Menaxhimit dhe Informacionit, Sistemet Operative, Telekomukacioni dhe Java dhe Ndërfaqje përdoruesi. Këto lëndë në programin mësimor janë në grupin e disiplinës të formimit karakterizues të programit i cili në total ka 90 kredite. Mbulimi i këtyre lëndëve në këtë disiplinë përbën 40% të tij</p> <p><i>Numri i të diplomuarve për periudhën e marrë në shyrtrim:</i></p> <p>Për vitin akademik 2016-2017 8 studente;</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018 14 studente;</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 29 studente;</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 19 studente;</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike ndjek një politikë sensibilizimi dhe informimi në lidhje me programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”. Në bashkepunim me Sektorin e Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturo – Sportive për vitin akademik 2019-2020 janë organizuar gjatë muajit Shkurt dhe Mars takime në 5 gjimnaze të Fierit, 2 shkolla të mesme të përgjithshme dhe 1 shkollë profesionale në Berat, 4 shkolla të mesme të përgjithshme dhe 1 shkollë industriale në Gjirokaster, 6 shkolla të mesme në Vlore, Dukat, Selenice, 1 shkollë Tregtare dhe 1 shkollë Industriale Vlorë. Për zhvillimin e këtyre takimeve pranë FSHTN-së është ngritur edhe grupi i punës të përbërë nga 3 pedagogë dhe 2 studentë [Ev.Raporti i analizës vjetore në</p>

	<p><i>department; Ev. Informimi i studentëve të rinj; Ev. Aktivitete për promovimin e UV Ev. Informimi i maturantëve].</i></p> <p>Në fund të aktiviteteve që zhvillohen në harkun kohor 1 mujor organizohet edhe aktiviteti i përditshëm “Open Day 2019” nën sloganin “Universiteti e Ardhmja Jote”. Ky aktivitet i zhvilluar në Rektorat me pjesëmarrës maturantë, prindër, mësues mundëson njohjen e ciklit të studimit, takime me pedagogë si edhe njohje me ambientet e studimit. Për sensibilizimin përdoren edhe fletepalosje ku theksohen programet e studimit për çdo fakultet. [Ev. Fletepalosje].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e saj. Ata janë në dijeni për detyrimet në lidhje me lëndët formuese sipas nivelit Bachelor të diplomës që ata zotërojnë. Kjo është përcaktuar qartë edhe në kriteret e pranimit në Rregulloren e programit të studimit. Në fillim të vitit akademik dhe në fillim të çdo lënde bëhet prezantimi nga ana e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi i syllabusit të lëndës dhe detyrimeve që duhet të plotësojnë studentët. GVJ konstatoi se studentët ishin të mirëinformuar në lidhje me përmbajtjen dhe strukturën e lëndës nga pedagogët e tyre. [Ev. takimi me studentët].
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	UV shpërndan informacion në website https://univlora.edu.al/rregullorja/ ku pasqyrohen Rregulloret dhe Statuti i UV-së duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë. Në website gjenden të publikuar edhe oraret e programit mësimor së bashku me informacionin për numrin e krediteve dhe pedagogun përkatës të lëndës (https://univlora.edu.al/fsht-departamenti-i-shkencave-kompjuterike/#). Syllabuset që çdo pedadog prezanton në fillim të lëndës japin informacion të qartë për përmbajtjen dhe kërkesat që studenti duhet të plotësojë. Udhëzimet në lidhje me pranimin, transferimin janë të pasqyruara në website.



Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.

UV ka krijuar edhe Sektorin e Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe aktiviteteve kulturore sportive e cila ndodhet në varësinë e Drejtorisë së Edukimit për Ciklin I & II. Ky sektor jep ndihmesën e tij në lidhje me informimin e studentëve, trajnimin e tyre në drejtim të punësimit, organizimin në bashkëpunim me grupet e ngritura në çdo Fakultet të aktiviteteve informuese me shkollat e mesme dhe profesionale në rajonin e Vlorës, takimin përfundimtar “Open Day” në ambientet e UV-së me prindër, nxënës, kolegë për të informuar në lidhje me programet e studimit, ambientet dhe infrastruktura në UV.

Ky sektor organizon edhe Panairin e Punës [Ev.Relacion mbi Pjesëmarrjen në Panairin e Punës 2019] në bashkëpunim me bizneset që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Vlorë, me Drejtorinë Rajonale të Punës në Vlorë. Ky sektor ka organizuar edhe workshop siçmund të përmendim “Studentë dhe Tregu i Punës” (2019) [Ev.Relacion mbi workshopi-in me temë Studentët dhe Tregu i Punës].Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe aktiviteteve kulturore – sportive mban lidhje të ngushtë me Alumni duke mundësuar kontaktet e vazhdueshme me to. Në fokus të punës qëndron edhe grumbullimi i të dhënave në lidhje punësimit e studentëve të diplomuar.

[Ev. Raporti vjetor i UV-së 2018-2019]

Numri i studentëve të diplomuar	Numri i të punësuarve në fushën e tyre	Në përqindje mesatarja
8	7	87.50%

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.

Për komunikim të brendshëm është ndërtuar sistemi UVMS. Tashmë ky sistem mundëson një shpërndarje informacioni dhe komunikimi me studentët në të gjithë nivelet. Për përdorimin e tij janë ndërtuar dy manuale përkatësisht për student dhe stafit akademik. Aksesimi në sistem bëhet përmes fjalëkalimit personal ku secili përdorues ka edhe një hapësirë të dedikuar <https://uvms.univlora.edu.al/user/login>. Funksionimi i kësaj platforme drejtohet dhe mirëmbahet nga sektori i IT-së. [Ev.takim me stafin e IT-së] Informacioni shpërndahet edhe përmes sekretarisë mësimore e cila luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve, tarifat e regjistrimit, notat etj.

Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë

GVJ konstatoi se Departamenti i Shkencave Kompjuterike në FSHTN zhvillon forma të larmishme në lidhje me sensibilizimin, informimin dhe mbështetjen ndaj studentëve. Numri i ulët i studentëve në këtë program mundëson një informim përmes


lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	<p>komunikimit aktiv pedagog – student. Format e informimit në mënyrë të përmbledhur janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Broshura, fletëpalosje; • Informim nga stafi akademik në lidhje me lëndët e programit të studimit, parmbajtjen e tyre përmes syllabuseve të çdo lënde, informacionin në çdo orë mësimi, informimin në lidhje me literaturën detyruese dhe ndihmëse; • Studenti informohet edhe nga strukturat e veçanta si Departamenti Shkencave Kompjuterike që jep udhëzime, vendime që prekin drejtpërdrejt procesin mësimor; • Sekretaria mësimore luan një rol aktiv në informimin e studentëve; • Sisemi UVMS që mundëson një akses të studentit në rregjistrimin në provime, në përcaktimin e progresit të tij në vit akademik etj; • Website i universitetit i cili informon studentët në lidhje me kuadrin ligjor në zbatim në UV, bursat dhe programet shkencore, aktivitetet që kryhen në territorin e UV-së, tarifatat për regjistrimin dhe pagesat në çdo vit akademik, mobilitetet për studentët dhe procedurat për aplikim etj; <p><i>[Ev. takim me stafin e IT-së; Ev. Takim me stafin akademik; Ev. Takim me sekretarinë mësimore]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	UV ka ngritur struktura të cilat menaxhojnë sistemin e informacionit për numrin e studentëve të regjistruar në çdo program studimi, për progresin e tyre dhe detyrimet që ata mbartin. Një nga strukturat më të rëndësishme është sekretaria mësimore që është e ngritur në çdo department. Sekretaria mësimore në Departamentin e Shkencave Kompjuterike funksionon mbi bazën e detyrave të përcaktuara në Statut dhe në Rregulloren e UV-së. <i>[Ev. Rregullore UV-së e ndryshuar].</i>

	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mbajtjen e regjistrimit bazë të studentit me të dhënat personale, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën dhe suplementin e saj; Rregjistri i studentit plotësohet me shkrim dhe mbahet edhe në formë elektronike; 2. Përpilon listën e studentëve të regjistruar, të transferuar dhe të larguar gjatë vitit akademik; 3. Këto të dhëna ruhen edhe në FSHTN dhe nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike; 4. Sekretaria në bashkëpunim me DSHK përpilon edhe listat e studentëve në çdo kurs së bashku me leksionet dhe seminarët si dhe mban informacion për mungesat e studentëve; 5. Ajo menaxhon edhe proces-verbalet për çdo provim së bashku me vlerësimet e bëra nga stafi akademik; 6. Sekretaria në bashkëpunim me hallkat drejtuese të DSHK dhe FSHTN-së informojnë studentët për çdo çështje apo njoftim që prek drejtëpërdrejtë procesin mësimor dhe studentët; 7. Sekretaria plotëson edhe regjistrin e diplomës duke siguruar që dorëzimi i saj të jetë bërë sipas kritereve të përcaktuar në Rregullore të UV-së; 8. Drejtorja e Informacionit dhe Teknologjisë ka në varësi të saj të drejtëpërdrejtë sekretaritë mësimore në lidhje me çështjet e regjistrimit, mbajtjes dhe përditësimit të të dhënave të studentëve; <p><i>[Ev.Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit; Ev.Statuti i UV-së , neni 12; Ev.Rregullore të UV-së e ndryshuar;]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave për numrin e studentëve të regjistruar, studentët e transferuar, studentët që largohen. Të dhënat ruhen në rregjistrat përkatës dhe në formë elektronike. Përgjegjës për menaxhimin e tyre në formë elektronike është Sektori IT-së. Të dhënat ruhen edhe në Departamentin e Shkencave Kompjuterike. Këto të dhëna shprehen në raportet vjetore që departamenti përgatit. Në nivel Institucioni është Drejtorja e Edukimit Cikli I & II që përgatit edhe raportet statistikore.</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për tre vite akademike rezulton:</p> <p>Viti akademik 2018-2019 17 studentë;</p>



	<p>Viti akademik 2019-2020 30 studentë;</p> <p>Viti akademik 2020-2021 27 studentë;</p> <p>Totali për një cikël studimi 74 studentë</p> <p><i>[Ev.Statuti i UV-së; Ev.Rregullore UV-së e ndryshuar; Ev.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Teknike].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi mirë-administrim të të dhënave të studentëve, dosjeve personale të tyre. Të dhënat ruhen mbi bazën e rregulloreve të brendshme të miratuara dhe aprovuara nga Dekanati i FSHTN, Senati Akademik dhe në përputhje me udhëzimet dhe direktivat në fuqi nga MASR. Të dhënat janë të aksesueshme nga hallkat dhe strukturat bazë dhe ndihmëse të UV-së pa cënuar konfidencialitetin e tyre. Të dhënat reflektohen edhe në raportet vjetore të DSHK dhe në raportet vjetore të UV-së. <i>[Ev.Raporti vjetor i UV për vitin 2017-2018; Ev.Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019; Ev.Raporti i analizës vjetore në departament]</i></p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen në sistemin e brendshëm të informacionit në hard copy dhe në formë elektronike. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luan edhe sistemi UVMS. Të dhënat ruhen të sigurta dhe mbrohen nga Neni 89 “Mbrojtja e të dhënave” në Rregulloren e UV-së. Institucioni punon mbi bazën e parimit të mbrojtjes së të dhënave dhe konfidencialitetit në përputhje me ligjin nr/9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Udhëzimin nr/07 date 09.06.2010 “Për Përpunimin e të Dhënave Personale në Sektorin e Arsimit”. <i>[Ev. Program i transparencës së UV].</i></p> <p>Të dhënat mbahen në mënyre manuale dhe elektronike nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Sektori i IT-së në Drejtorinë e e Edukimit të Ciklit të I & II. Në UV janë të përcaktuar personat të cilët kanë akses në të dhënat personale manuale dhe ato në sistemin elektronik. Çdo dokument i bazuar në të dhënat e UVMS verifikohet në database me formatin hardcopy (regjistrat e ndryshëm etj) dhe merr formë ligjore kur nënshkruhet nga personi përgjegjës. <i>[Ev.Rregullore UV-së e ndryshuar, neni 89].</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e</p>	<p>Të dhënat statistikore përpunohen në trajtën e raporteve periodike vjetore të DShK. FSHTN dhe të UV-së. GVJ gjeti evidenca të qarta të përpunimit të të dhënave statistikore në raportet vjetore dhe pasqyrimin dhe progresin e procesit mësimor në vite (periudha 2016-2020). <i>[Ev.Raporti vjetor i UV për vitin 2017-2018; Ev.Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019; Ev.Raporti i analizës vjetore në departament].</i></p>

<p>duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në këto raporte pasqyrohet kalueshmëria e studentëve për të tre vitet e studimit. Për periudhën 2016-2019 kalueshmëria e studentëve luhet në 35-40% për vitin e I-rë, 40-60% për vitin e II-të dhe 60-80% për vitin e III-të. Për programin Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” për vitin 2018-2019 kalueshmëria ka qënë 45% me një cilësi 6.45 [Ev.Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019]. Kjo kalueshmëri është cilësuar më e mirë në krahasim me programet Bachelor “Teknologji Informacioni” dhe Bachelor në “Informatikë” nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike ndonëse në të dhënat e pasqyruar në raportin vjetor të UV-së ky program për vitin akademik 2018-2019 ka kalueshmërinë më të ulët.</p> <p>[Ev. Raporti i analizës vjetore në department; Ev.Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019].</p> <p>Në lidhje me punësimin e studentëve GVJ nuk gjeti evidencë të qarta. Në evidencën VI.2 “Plotësimi i rekomandimeve të mëparshme” theksohen disa të dhëna në lidhje me gjurmimin dhe punësimin e studentëve pas diplomimit të tyre. Në lidhje me FSHTN rezulton se 69% e studentëve të diplomuar punojnë në profesionin e tyre. [Ev.Plotësimi i rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>GVJ konstatoi një kuadër ligjor të qartë në lidhje me përfaqësimin e studentëve në vendimarrje. Në përmbushje të rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit (ASCAL) me vendimin nr, 71 datë 21.09.2017, pika 6 “Universiteti të marrë masa për ngritjen e Këshillit Studentor”. Me vendim Senati nr.16 datë 28.03.2019 është miratuar edhe Rregullorja e Zgjedhjes të Këshillave Studentore në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë. Në Statut, neni, 74 shpreh parimisht të drejtën e studenteve dhe përfaqësimin e tyre në nivel njësie kryesore, në nivel universiteti si edhe në nivel kombëtar. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy</p>

	<p>vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten nga legjislacioni në fuqi. Mënyra e funksionimit të këshillave të studentëve përcaktohen në Rregulloren e UV-së duke marre në konsiderate propozimet e studentëve. Universiteti mbështet Këshillat e Studentëve dhe financon veprimtarinë e tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje (detyrime këto që rrjedhin tek Kodi i Cilësisë).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët janë anëtarë në pilotimin e draft – pyetësorit për “Vlerësimin e Cilësisë së Shërbimeve dhe performancës së stafit ndihmës-akademik dhe administrativ; • Studentët janë anëtarë grupi në përgatitjen e RVB-së; • Studentët janë anëtarë grupi për përmirësimin e pyetësorit për “Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për çdo program studimi në UV”; • Studentët janë anëtarë në komisionet ad – hoc për përzgjedhjen e studentëve përfitues të bursave ERSMUS+ICM; • Ata janë në grup pune në projekte të financuara nga programi ERSMUS – CBHE <p><i>[Ev.Raporti vjetor i UV per vitin 2018-2019; Ev.Statuti i UV-së, Ev.Analiza e rezultateve të anketimit të studentëve mbi stafin akademik të DSHK; Ev. Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017-2018; Ev. Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019; Ev. Draft Rregullorja e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë].</i></p> <p>Studentët kanë përfaqësimin e tyre edhe në komisionet e ngritura në UV.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në Nivel Institucional që përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë personel akademik dhe 1 (një) student që vetkandidohet dhe zgjidhet nga Senati Akademik për një mandate 2 – vjeçar me të drejtë rizgjedhje; • Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët në Nivel Insitucional (KMSI) i cili që përbehet nga 6 (gjashtë) anëtare personel akademik dhe 1 (një) student që vetkandidohet dhe zgjidhet nga Senati Akademik për një mandate 2 – vjeçar me të drejtë rizgjedhje; • Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në FSHT i cili që përbehet nga 6 (gjashtë) anëtare personel akademik dhe 1 (një) student që vetkandidohet dhe zgjidhet nga Asambleja e Personelit Akademik të Njësisë

	<p>kryesore midis anëtarëve të saj dhe studentëve me kohë të plotë me një mandate 2 vjeçar;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komisionet e Marrëdhënieve me studentët për çdo Fakultet ku përfshihet edhe FSHT përbëhen nga 6 (gjashtë) anëtarë personel akademik dhe 1 (një) student që vetkandidohen dhe zgjidhen nga Asambleja e Personelit Akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj dhe studentëve me kohë të plotë me një mandat 2 vjeçar; <p>Gjithsesi duhet të theksojmë që Institucioni është akoma në proces të ristrukturimit dhe ende është duke punuar në këtë drejtim me mbushjen e këtyre komisioneve me anëtare. <u>Rekomandojmë që institucioni duhet të bëjë plotësimin e këtyre komisioneve në mënyrë që të garantohet përfaqësimi institucional dhe në vendim-marrje të studentëve.</u></p> <p>[Ev. Draft Rregullorja e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë]</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar për këtë program studimi në vijueshmëri zhvillon punë në lidhje me përmirësimin e përmbajtjes së lëndëve pjesë përbërëse e këtij program [Ev. Raporti i analizës vjetore në department]. Në drejtim të përmirësimit merret mendimi nga progresi i fushës së shkencave kompjuterike, eksperiencia e marrë nga pjesëmarrja në trajnime dhe konferenca ndërkombëtare, mendimi sugjerimet e studentëve në komunikimin e drejtpërdrejtë ose nga pyetorët e plotësuar. Ky përmirësim lehtëson ngarkesën teorike të studentëve dhe ka prioritet në zhvillimin më të madh të praktikës gjatë orëve laboratorike duke mundësuar një aftësim më profesional të tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët janë pjesë e procesit të rishikimit të programit mësimor. Përmes plotësimit të anketimit ata shfaqin mendimin e tyre në lidhje me dobësitë në procesin mësimor dhe shërbejnë si mjet për ndërmarrjen e hapave në lidhje me përmirësimet që kërkohen. Në këtë drejtim mendimi i studentëve është marrë edhe për propozimin dhe përfshirjen e praktikës profesionale në programin mësimor të rishikuar. Kjo kërkesë u shfaq edhe në takimin me studentët dhe në takimin me stafin akademik. Ata dëshmuar se përfshirja në kurrikulë të praktikës profesionale mundëson një aftësim më të mirë të studentëve në drejtim të praktikës dhe të punësimit të tyre në të ardhmen. Bazuar edhe në rezultatet e anketimeve janë bërë edhe përmirësimet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Literaturë duke përfshirë botimet më të fundit; • Përdorimin e teknikave bashkëkohore në mësimdhënie dhe zhvillimit të mësimin në mënyrë interaktive • Konkretizimin e teorisë me shembuj praktikë;

	<ul style="list-style-type: none"> • Përfshirjen e studentëve në analizimin e punimeve shkencore të autorëve vendas apo të huaj duke nxitur dialogun dhe stimuluar mendimin kritik përmes dhënies së konkluzioneve dhe rekomandimeve; • Përfshirja sa më shumë e rasteve praktike të studimit gjatë orëve të seminareve; • Përmirësimi i kushteve të auditorëve dhe infrastrukturës në tërësi; • Vendosija e bibliotekës në godinën C të FSHT-së; <p>[Ev. Analiza e rezultateve të anketimit të studentëve mbi stafin akademik të DSHK; Ev. Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017-2018; Ev. Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019; Ev. Plani i Masave për përmirësimin e cilësisë në DSHK]</p>								
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Të gjithë aktet ligjore në fuqi, strukturat e ngritura ku studentët kanë të drejtën e përfaqësimit, garantojnë marrjen e mendimit dhe shprehjen e lirë të saj në procesin e vlerësimit të programit të studimit. GVJ bazuar në takimet me studentët dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit konkludon se studentët kanë të drejtën e vlerësimit të kontrollit të dijeve të bëra nga stafi akademik dhe të drejtën e ankimit. GVJ konstatoi në takimin me studentët se ata ishin të mirëinformuar në këtë drejtim. Praktika të ankimit u paraqitën nga institucioni dhe rastet sporadike u epërmendën edhe në takimet me stafin akademik dhe studentët.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>UV zhvillon aktivitetin e tij bazuar në parimin e informimit dhe shërbimit të studentëve. Për këtë dokumentat ligjore garantojnë detyrat dhe përgjegjësitë që secila strukturë e ngritur në UV të jetë në shërbim dhe në funksion të studentëve. Në këtë drejtim një ndihmesë japin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Edukimit për Ciklin I & II e përbërë nga sektori i Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve ku

	<p>edhe FSHT ka një specialist të dedikuar tek zyra e studentit në shërbim të studentëve si edhe Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore dhe Sportive që ofron këshillim, trajnime dhe ndihmë studentëve në drejtim të punësimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këshilltari akademik në FSHT që ofron ndihmë dhe asistencë në drejtim të progresit të studentëve dhe shqyrtim të çështjeve të ngritura ; • Sekretaria Mësimore; • Sektori IT –së. <p><i>[Ev. Statuti i UV-së; Ev.Rregullore UV-së e ndryshuar; Ev.Rregullore e Departamentit të Shkencave Kompjuterike, Ev. Rregullore e FSHT-së]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” është emëruar edhe Këshilltari Akademik në FSHTN, i cili në fokus të punës së tij ka edhe informimin, këshillimin dhe ndjekjen e progresit të studentëve. <i>[Ev. Këshilltari akademik]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore dhe Sportive zhvillon punë me studentët në drejtim të punësimit të tyre pas përfundimit të studimeve. Në këtë drejtim në fokus të punës së tij është lehtësimi i rrugëtimit të studentëve në punësim përmes ofrimit të këshillimit, informimit për oferta punësimi dhe këshillimit mbi përgatitjen e cv-së dhe pyetjeve në intervista. Kjo zyrë shëben edhe si urë lidhje midis kompanive të biznesit dhe studentëve e cila realizohet përmes organizimit të Panairit të Karrierës. Në Planin strategjik 2018 – 2024 është theksuar në linjen strategjike nr.1: ESCO Standart, rishikimin e veprimtarisë së zyrës së orientimit dhe karrierës bazuar në ESCO standart, duke orientuar fokusin dhe shërbimin e zyrës drejt punësimit sipas qasjes “Coach for Employment”. Institucioni ka kryer një punë të mirë në lidhje me nënshkrimin e shumë marrëveshje bashkëpunimi. Në Linjën Strategjike Nr.3: Diploma, Punësimi synohet në zgjerimin e aktivitetit të zyrës së karrierës me shërbime në funksion të punësimit të studentëve duke luajtur rolin e ndërmjetesit midis tregut të punës dhe universitetit.</p> <p><u>GVJ konkludon që në këtë drejtim duhet të punohet më shumë, duke konsideruar që aktivitetet që ky sektor kryen, impakti i bashkëpunimit të universitetit me biznesin dhe mungesa e të</u></p>

	<u>dhënave në lidhje me gjurmimit e studentëve të diplomuar nuk janë plotësisht të përmbushura.</u>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga takimi i zhvilluar me përfaqësues nga ky sektor u theksua puna në lidhje me grumbullimin e të dhënave në lidhje me studentët pas diplomimit të tyre. Në raportin vjetor të UV-së për vitin akademik 2018-2019 jepen të dhëna në lidhje me gjurmimin e studentëve për FSHTN por nuk na u paraqitën të dhëna specifike nga Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore dhe Sportive për studentët e diplomuar në këtë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR



Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Institucioni ka të garantuar sigurimin e brendshëm të cilësisë e shprehur në nenin 80 të Statutit të UV-së. UV-ja harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Sigurimi i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akadmeike, administrative dhe financiare të institucionit. Në këtë kuadër UV-ja i nënshtrohet vlerësimit periodic institucional dhe vlerësimit të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Veprimtaria e Strukturës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë funksionon bazuar edhe në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr.80/2015, Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.531 datë 11.09.2018, Planit Strategjik 2018-2024 të UV-së si edhe Manualit të Procedurave dhe Afateve për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Programeve të Studimit.



<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka të ngritur edhe Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional ku pjesë përbërëse e saj është Sektori i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional. <i>[Ev.Vendim Senati nr.84 date 12.12.2016; Ev. Vendim Senati nr.8 datë 14.02.2018]</i></p> <p>Në Statut janë përcaktuar qartë edhe ngritja e Komisioneve të Përhershme Kolegjiale që lidhen me garantimin e standarteve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Komisioni i Sigurisë së Cilësisë së Brendshme për çdo njësi kryesore (KSFBF) i përbërë nga shtatë anëtarë ku 1 (një) anëtar është student me mandat 2 vjeçar. 2. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në nivel Institucional (KSBCI) i përbërë nga katër anëtarë ku 1 (një) është student; 3. Komisionet e Marrëdhënieve me studentët për çdo fakultet (KMSF); <p>Në këtë drejtim është hartuar edhe Rregullorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila është çuar në Senatin Akademik për miratim. <i>[Ev.Draft Rregullorja e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë ka krijuar një Sistem të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i cili funksionon në të gjithë nivelet institucionale. Në Planin Strategjik 2018 – 2014 është theksuar si shtylla 7 “Sigurimi i Cilësisë dhe Standarteve”. Në këtë drejtim synohet të respektohet dhe zhvillohet puna akademike në cilësi të lartë dhe në përputhje me standartet europiane ESCO të Komunitetit Evropian. Bazuar në këtë strategji synohet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Njehsimi i sistemit actual të vlerësimit me vlerësimin sipas standarteve ESCO; 2. Përmirësimi i syllabuseve për çdo program studimi pjesë e të cilit është edhe programi Bachelor “Shkenca Kompjuterike” <p><i>[Ev.Plani Strategjik 2018-2024]</i></p> <p>Në 2020, UV ka qenë objekt i vlerësimit institucional të jashtëm të ndërmarrë nga ASCAL. Ky process akreditimi u shoqërua me një vlerësim pozitiv dhe kohëzgjatje 5 (pesë) vjeçare, Vendim i BA Nr. 50, datë 27.11.2020. Raporti i vlerësimit të jashtëm i akreditimit të mëparshëm institucional përmban edhe shume rekomandime të cilat institucioni është përpjekur ti realizojë. Në këtë drejtim, Rekomandimi 3 citojmë: “...Universiteti duhet të ngreje Njësi të Brendshme të Sigurimit të Cilësisë sikurse është parashikuar në Planin e tij të Zhvillimit synon në krijimin e</p>



	<p><i>strukturave te brendshme te cilat do te garantojne edhe cilësinë në standartet e procesit mësimor”.</i></p> <p>Bazuar në këtë rekomandim tashmë UV ka ngritur edhe Drejtorinë e e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional ku Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional është një prej tre sektorëve përbërës të kësaj drejtorie. Senati Akademik është duke miratuar edhe Rregulloren e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional e cila i është paraqitur si evidencë GVJ-së. <i>[Ev.Statuti i UV-së, neni 13, neni 22 dhe neni 23; Ev. Plotësimi i rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm; Ev. Draft Rregullorja e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë].</i></p> <p>Në funksion të përmirësimit të procesit mësimor NJSBC dhe Vlerësimit Institucional ka ndërmarrë hapa konkrete në bashkëpunim me Fakultetet dhe departamentet. <i>[Ev. Raporti i analizës vjetore në departament; Ev.Raporti vjetor i UV për vitin 2017-2018; Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019].</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Në Statut, Rregulloren e UV-së, Rregulloren e NJSBC dhe Zhvillimit Insitucional janë të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë në drejtim të garantimit e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në punën e saj institucioni dhe NJSBC veprojnë sipas ligjit nr. 80/2015, rekomandimeve nga procesi i akreditimit të jashtëm intitucional, nga manuali i procedurave dhe afateve për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të programeve të studimit. Në Planin Strategjik 2018-2014 në hapat konkrete që UV synon në drejtim të plotësimit të standarteve dhe objektivave afatmesëm dhe afatgjatë janë dhënë edhe aktivitetet që duhet të realizohen. NJSBC është pjesë e planit të punës dhe bashkërendimit me hallkat e tjera në plotësimin e synimeve të vendosur në 8 shtyllat kryesore të kësaj strategjie.</p> <p><i>[Ev.Plotësimi i rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm; Ev.Statuti i UV-së; Ev.Plani Strategjik 2018-2024; Ev.Rregullore UV-se e ndryshuar]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Neni 13, neni 22 në Statut të UV theksojnë rolin dhe detyrat e komisioneve të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe NJSBC. Në këtë drejtim tashmë është konsoliduar veprimtaria e NJSBC dhe Vlerësimit Institucional, ndërsa akoma po punohet në drejtim të formimit të Komisioneve. <i>[Ev.Plotësimi i rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm; Ev.Statuti i UV-së].</i></p> <p>NJSBC dhe Vlerësimit Institucional zhvillon veprimtarinë e saj në kuadër të Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UV. Ajo është në varësi të Rektorit dhe realizon në praktikë politikat e UV-së në fushën e sigurimit të cilësisë, në vlerësimin insitucional dhe vlerësimin e programeve të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguron mbështetje dhe këshillim për proceset e akreditimit; • NJSBC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe shkencore; • Vlerësimi i brendshëm realizohet sipas udhëzimeve përkatëse të ASCAL-it. Përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimit të brendshëm mbështeten në analizat statistikore të të dhënave, në konstatimet e nxjerra nga rregjistrat, në sondazhet, pyetsorët dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin ndihmës-akademik dhe administrativ si edhe studentët; • Bashkëpunon me NJSBC të intitucioneve të tjera të Arsimit të Larte duke shkëmbyer përvojë në drejtim të rritjes së cilësisë dhe plotësimit të standarteve; • Përgjigjet për hartimin dhe përpilimin e dokumentave të nevojshëm për mirëfunksionimin e NJSBC-së duke respektuar kuadrin ligjor që mbështet veprimtarinë e UV-së; <p><i>[Ev.Draft Rregullorja e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>UV përdor mekanizma dhe procese për shqyrtimin dhe monitorimin e programit të studimit. Kjo realizohet përmes:</p> <p>a) përcaktimit të kriterëve dhe afateve të hartimit, ristrukturimit dhe përmirësimit të programit sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore, te UV-së;</p> <p>GVJ u ndesh me praktikën për ndryshime mbi 20% në programin e studimit Bachelor “Shkenca Kompjuterike”. Këto ndryshime u diktuan nga përmirësimi në përmbajtjen e programit mësimor si pasojë e zhvillimeve bashkëkohore teknologjike. Propozimi për</p>

fuqjen e praktikës profesionale në program u diktua nga kërkesa e tregut dhe kërkesa e vetë studentëve.

- b) standardeve dhe kriterëve të cilësisë së programit të studimit ;

GVJ u njoh me raportet vjetore të DSHK të cilat jepnin një analizë të cilësisë së mësimdhënies, kalueshmëria e shprehur në përqindje për secilën lëndë, analizën kërkimore shkencore të stafit akademik dhe sigurimi i realizimit të masave ku vlen të përmenden:

1. Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së studentëve;
2. Rritja e pjesëmarrjes së stafit akademik në projekte kërkimore shkencore. Organizimi i konferencës së dytë ndërkombëtare NRA-CSIT 2029 nga DSHK në muajin Tetor 2019;
3. Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së publikimeve shkencore të stafit akademik;
4. Përgatitja e kurseve që mund të ofroje departamenti në gjuhë të huaj (anglisht dhe italisht);



Në UV është ngritur edhe Drejtoria e Edukimit të Ciklit të I& II që merret me vlerësimin e propozimeve për ndryshim në programin mësimor të cilat vijojnë më pas me miratimin në Senatit Akademik. Në takimin e zhvilluar kjo Drejtori ka aplikuar edhe në MASR për ndryshim në programin mësimor Bachelor “Shkenca Kompjuterike”. *[Ev.Praktikën e dorëzuar në MASR për riorganizimin e programeve të studimit Bsc ne Shkenca Kompjuterike].*

- c) cilësisë dhe numrit të kërkuar të personelit akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin;

Në takimet e zhvilluara me drejtues të Departamenti të Shkencave Kompjuterike dhe në shqyrtimin e dokumentacionit evidentohet një punë serioze në lidhje me punësimin e stafit akademik me grada shkencore. Në drejtim të stafit akademik ndihmës – mësimor GVJ gjeti shembuj të punësimit të studentëve të diplomuar në këtë departament.


- d) politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare dhe aplikimit të teknologjisë mësimore bashkëkohore bazuar edhe në rekomandimet e dhëna nga procesi i vlerësimit të jashtëm institucional;

GVJ gjeti evidenca në raportet vjetore të DSHK dhe në analizën e UV-së në plotësimin e rekomandimeve nga procesi i vlerësimit të jashtëm në përmirësimin e teksteve duke përzgjedhur ato bashkëkohore. Në raportin vjetor të DSHK-së theksohet edhe



	<p>përmiresimi i dy laboratorëve të informatikës me softuerë që i përgjigjen më mirë kuadrit teorik të lëndëve në këtë program studimi.</p> <p>e) infrastrukturës mësimore;</p> <p>Në drejtim të infrastruktures u konstatua rikonstruksioni i Godinës C ku zhvillohet programi mësimor Bachelor “Shkenca Kompjuterike”. Kërkesa nga studentët dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike. <i>[Ev.Raporti i analizës vjetore në departament]</i> për krijimin e një bibliotekë në Godinen C është plotësuar.</p> <p>f) ndërkombëtarizimit të programeve;</p> <p>g) monitorimit, vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit.</p> <p>UV ka krijuar edhe Drejtorinë e Edukimit të Ciklit të I& II si edhe NJSBC të Vlerësimit Institucional të cilat në fokus të punës së tyre kanë monitorimin, vlerësimin e brendshëm të programeve dhe zbatimin e procedurave në lidhje me akreditimin e programit mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>NJSBC përdor metodologji studimi të miratuar nga Senati Akademik nr.52 datë 20.04.2017. Pyetsori shpërndahet në fund të çdo semestri akademik. Bazuar në raportet vjetore të NJSBC-së evidentojmë një përmirësim të stukturës së anketimit. Për vitin 2018-2019 ky pyetsor është hedhur në sistemin UVMS dhe është plotësuar nga të gjithë studentët të cilët kanë janë konsideruar “ të rregullt” pra kanë frekuentuar programin mësimor. Studentët përsëritës nuk kanë patur të drejtën të bëjnë plotësimin e këtij pyetsori. Pyetsori përmban 14 pyetje të mbyllura dhe 2 pyetje të hapura. Pyetjet e mbyllura janë përpunuar statistikisht nga sistemi përmes programit në UVMS. Analiza e të dhënave të pyetsorëve është organizuar në dy seksione të cilat përkohësisht me organizimin e tij. Përgjigjet për çdo pyetje janë gjeneruar prej sistemit UVMS dhe janë të shprehur në përqindje. Konsiderojmë këtu edhe llogaritjen e marzhit të gabimit. Vlerësimi për lëndët përkatëse është kushtëzuar vetëm në vlerësimin e pedagogut titullar të lëndës pasi studentët nuk mund të regjistrohen përmes sistemit UVMS për seminarët në lëndët respektive. Përgjigjet e pyetsorit janë ruajtur dhe përpunuar në mënyrë anonime. <i>[Ev.Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017-2018; Ev.Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019; Ev. Analiza e rezultateve të anketimit të studentëve mbi stafin akademik të DSHK; Ev. Shembull i pyetsorëve të rinj që janë duke u hartuar, Pyetesori i Stafit</i></p>



	<p><i>Akademik i permiresuar; Ev. Shembull i pyetsorëve të rinj që janë duke u hartuar, Pyetesori i Stafit Ndhimes Administrativ]</i></p> <p>Në programin e studimit Bachelor “Shkenca Kompjuterike” gjatë vitit akademik 2018-2019 referuar të dhënave të gjeneruara nga UVMS mesatarja e pjesëmarrjes së studnetëve në plotësimin e pyetsorëve e shprehur në përqindje është:</p> <table border="1" data-bbox="710 481 1278 667"> <thead> <tr> <th data-bbox="710 481 943 607">Nr. i studentëve të regjistruar në çdo lëndë (sem 1+2)</th> <th data-bbox="948 481 1090 607">Pyetsor të plotësuar</th> <th data-bbox="1094 481 1278 607">Pjesëmarrës në %</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="710 613 943 667">513</td> <td data-bbox="948 613 1090 667">477</td> <td data-bbox="1094 613 1278 667">93%</td> </tr> </tbody> </table>	Nr. i studentëve të regjistruar në çdo lëndë (sem 1+2)	Pyetsor të plotësuar	Pjesëmarrës në %	513	477	93%
Nr. i studentëve të regjistruar në çdo lëndë (sem 1+2)	Pyetsor të plotësuar	Pjesëmarrës në %					
513	477	93%					
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>NJSBC për çdo vit akademik harton një raport vjetor i cila paraqitet tek organet drejtuese të UV-së, shpërndahet në fakultet dhe në departament. Këto të fundit bazuar edhe në vlerësimet e bëra marrin edhe masa e duhura për përmirësime. <i>[Ev.Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017-2018; Ev.Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor për vitin akademik 2018-2019].</i></p>						
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Rezultatet e mbledhura të pyetsorëve përpunohen në formë raporti. NJSBC ofron edhe rekomandimet përkatëse të cilat merren në konsideratë për përmirësim. GVJ gjeti përmirësime të bëra në matjen e vlerësimit të programit të studimit në vite. Deri në periudhen 2018 shpërndarja e pyetsorëve është bërë në mënyre manuale. Kufizmet dhe pengesat janë shprehur edhe në raportet vjetore. <i>[Ev.Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017-2018; Ev.Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor për vitin akademik 2018-2019].</i> Për vitin 2017-2018 janë hasur një sërë kufizimesh teknike dhe metodologjike ku përmendim:</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Organizimi i pyetsorit është bërë vetëm për ciklin e parë duke mos përfshirë studentët që ndjekin ciklin e dytë;</i> <i>Pjesëmarrja e ulët e studentëve në plotësimin e pyetsorëve gjate semestrit të dytë të vitit akademik 2017-2018;</i> <i>Të dhënat e pyetsorëve dhe paraqitja grafike e tyre është përpiluar në mënyre manuale dhe elektronikisht duke sjelle shumë vonesë në hartimin e raportit.</i> <p>Në këtë drejtim është sugjeruar që të përgatitet platforma UVMS për hedhjen e pyetsorit me qëllim lehtësimin e punës në drejtim të gjenerimit të të dhënave. Në raportin vjetor të vitit akademik 2018-2019 NJSBC ka plotësuar rekomandimin. UVMS është aktive dhe 14 pyetjet e mbyllura tashmë gjenerohen në mënyrë automatike duke dhënë përpunimin statistikordhe grafikët dhe duke ofruar</p>						



	<p>njékohësisht edhe një analizë krahasuese me përgjigjet e dhëna për vitin akademik parardhës. [Ev.Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017-2018; Ev.Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019]</p> <p>Rekomandimet dhe analiza e paraqitur në raportin e NJSBC merren në konsiderate dhe për këtë hartohet një plan masash të cilat miratohen nga Senati Akademik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyshet plotësisht	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Vlerësimi i programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike kryhet nga NJSBC dhe Vlerësimin Institucional. Në kuadër të ndryshime në program Departamenti i Shkencave Kompjuterike bashkërendon punën e tij me Drejtorinë e Edukimit të Ciklit të I & II. Raportet vjetore të përgatitura nga DShK përmbajnë të gjithë elementët e vlerësimit të brendshëm të programit. Në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës DSHK bashkërendon punën e tij me Bordin e Administrimit. [Ev.Raporti i analizës vjetore në departament]</p> <p>Të dhënat e mbledhura shërbejnë për hartimin e raporteve vjetore të UV-së dhe janë një bazë të dhënash që mundësojnë hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm në nivel programi dhe në nivel institucional. [Ev. Takim me anëtare të RVB-së].</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Neni 8 në Rregulloren e NJSBC dhe Vlerësimin Institucional përcakton qartë metodat e drejtpëdrejta dhe të tërthorta që ky sektor kryen vlerësimin e cilësisë së programit mësimor. Këto metoda janë të miratuara nga Senati Akademik dhe janë subjekt ndryshimi. GVJ gjeti evidencë të praktikës së përmirësimit të përmbajtjes së pyetësorëve për vitin akademik 2020-2021. [Ev.Shembull i pyetësorëve të rinj që janë duke u hartuar, Pyetesori i Stafit Akademik i përmirësuar; Ev. Shembull i pyetësorëve të rinj që janë duke u hartuar, Pyetesori i Stafit Ndhimes Administrativ]</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimet paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>NJSBC në Rregulloren e saj përcakton qartë metodat dhe instrumentat e vlerësimit. Metodatat e tërthorta konsistojnë në sondazhet dhe intervistat e studentëve, sondazhet me studentët e diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmes akademik e administrativ. GVJ konstatoi veprimtarinë e NJSBC në FSHTN në drejtim të vlerësimit të programit të studimit dhe në drejtim të kërkimit shkencor. Në thelb të veprimtarisë së saj qëndron analiza e procesit mësimor me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij. Për realizimin e procesit të vlerësimit NJSBC përdor metoda të matjes së drejtpërdrejtë dhe kontrollit periodik të procesit mësimor. Në vlerësimin e drejtpërdrejtë përmendim vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësimin të didaktikës, kurrikulës, përmes pyetsorëve që shpërndahen në fund të çdo semestri dhe përpunimin statistikor të tyre.</p> <p>GVJ konstatoi që për vitin 2020 është ngritur një grup pune i cili në fokus ka përmirësimin e pyetsorit të studentëve. GVJ gjeti shembuj në takimet me studentët dhe stafin akademik që konfirmojnë punën që Departamenti i Shkencave Kompjuterike zhvillon në matjen e drejtpërdrejtë të cilësisë së mësimdhënies përmes vëzhgimeve në orët mesimore, leksione dhe seminare, orëve laboratorike. DSHK monitoron edhe kërkimin shkencor dhe rezultatet e arritura për çdo anëtar të stafit akademik dhe të dhënat janë të shprehura qartë në raportet vjetore që përgatit në fund të çdo viti akademik.</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>DSHK kontrollon dhe moniton procesin mësimor. Çdo lëndë i nënshtrohet një vlerësimi ku përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli i vlerësimit me nota/pikë (në proceverbalet e plotësuar për çdo lëndë nga stafi akademik); • Kontrolli i testimeve të pjeshme dhe përfundimtare; • Kontrolli i procesit të mësimdhënies; • Kontrolli në lidhje me shfrytëzimin e infrastrukturës (kryesisht klasat, laboratorët dhe mjetet didaktike) • Kontrolli i detyrave/projekteve të kursit; <p><u>GVJ rekomandon që të zgjerohet spektri i sondazheve edhe në drejtim të stafit akademik dhe alumni. GVJ rekomandon që duhet të bëhet nga Sektori i Këshillimit të Studentëve, Alumni dhe aktiviteteve sportive-kulturale në drejtim të krijimit të një database për gjurmimin e studentëve të punësuar dhe përthithjen e mendimit të alumnit.</u></p>				
	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <td style="width: 25%; background-color: #cccccc;">Nuk përmbyhet</td> <td style="width: 25%; background-color: #cccccc;">Përmbyhet pjesërisht</td> <td style="width: 25%; background-color: #cccccc;">Përmbyhet kryesisht</td> <td style="width: 25%; background-color: #cccccc;">Përmbyhet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
Nuk përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht		

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UV garanton krijimin e një strukture të vlerësimit të brendshëm të cilësisë e cila është gjithëpërfshirëse. GVJ konstaton veprimtarinë saj të zhvillohet në nivel program studimi, departamenti, fakulteti dhe në nivel institucion dhe vendimarrës. [Ev. Statuti i UV-së; Ev.Draft Rregullorja e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ konstaton që sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë në UV ka një strukture të mirëpërcaktuar ligjore. Në dokumentat bazë të Institucionit, në Rregulloren e NJSBC dhe Vlerësimit Institucional janë dhënë qartë detyrat dhe përgjegjësitë konkrete për DSHK, stafin akademik, NJSBC dhe studentët.</p> <p><u>GVJ rekomandon që ndonëse detyrat për Komisionin e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në Nivel Institucional (KSBCI), Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët në Nivel Institucional (KMSI), Komisionet e Sigurimit të Cilësisë për çdo Fakultet (KSCBF), Komisionet e Marrëdhënieve me Studentët për çdo Fakultet (KMSF) ku përfshihet këtu edhe Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore duhet të formohen duke lehtësuar ngarkesën e NJSBC dhe duke krijuar një hierarki pune nga poshtë – lart për të identifikuar më qartë problematikat dhe për monitoruar dhe garantuar më mirë sigurimin e cilësisë në programin mësimor.</u></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së programit të studimit Bachelor “Shkenca Kompjuterike” është garantuar përmes një procesi gjithëpërfshirës. GVJ konstatoi një pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve, DSHK, dekanatit të FSHTN në këtë proces [Ev. Statuti i UV-së; Ev.Draft Rregullorja e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë].</p>

TF.

<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në veprimtarinë e saj NJSBC mbështetet edhe nga struktura të tjera të ngritura me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në punën e saj ajo zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit dhe shmang çdo lloj pabarazie dhe diskriminimi. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimimit në lidhje me procesin e sondazheve të kryera nga ky sektor.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Mungesa e praktikës profesionale nuk mundëson DSHK të përthithë edhe mendimin e ekspertëve të jashtëm në lidhje me procesin mësimor. Vendosija e praktikës profesionale në programin e rishikuar do të sjellë një ndërveprim më aktiv me kompanitë e biznesit dhe do të lehtësojë marrjen e opinionit të tyre në lidhje me përmbajtjen e programit dhe ajo çfare nevojitet të përmirësohet. Ndonëse në RVB dhe në takime u përmend organizmi i workshop-it “Studentët dhe Tregu i Punes” GVJ është i mendimit që këto janë raste shumë të pakta për të dhënë të qartë impaktin në lidhje me përthithjen e mendimit për cilësinë në këtë program studimi. [Ev.Praktikën e dorëzuar në MASR për riorganizimin e programeve të studimit Bsc ne Shkenca Kompjuterike; Ev.Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstaton transparencë të procesit të vlerësimit të cilësisë në programin e studimit. Shpërndarja e pyetsorëve, përpunimi i tyre dhe rezultatet e sondazheve komunikohen në të gjithë hallkat pjesë përbërëse e këtij procesi. Rezultatet e pyetsorëve shpërndahen në DSHK e cila më pas ndërmerr edhe masat për përmirësim. Të dhënat nga matjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ndërmarra nga NJSBC përpunohen në formë statistikore dhe shprehen qartë në raportet vjetore. Ato janë burim masash të miratuara nga Senati Akademik për ndryshimet e propozuara. Vendimet kryesore të lidhura drejtpërdrejtë me këtë process transmetohen tek studentët</p>

	dhe stafi akademik. [Ev. Statuti i UV-së; Ev.Draft Rregullorja e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë]
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	NJSBC harton çdo vit raportin vjetor i cili ju komunikohet të gjithë hallkave përfshirë në këtë process. Informacioni i publikuar në raport respekton lirinë akademike si edhe ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr.48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit dhe mosdiskriminimit. [Ev. Statuti i UV-së; Ev.Program i transparencës së UV]
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ gjeti shembuj dhe dëshmi të masave përmirësuese që DSHK ka marrë bazuar edhe në rekomandimet e NJSBC e vlerësimit institucional. [Ev.Plani i Masave për përmirësimin e cilësisë në DSHK]. Bazuar në rekomandimet e shprehura në raportin vjetor 2018-2019 të NJSBC dhe Vlerësimit Institucional, Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka ndërmarre edhe masat e mëposhtme : a. Përdorimi i literaturës bashkëkohore që i përket autorëve më të mirë të fushës; b. Përdorimi i teknikave bashkëkohore në mësimdhënie dhe zhvillimit të mësimin në mënyrë interaktive; c. Konkretizmit të teorise me shembuj në praktikë; d. Përfshirjen e studentëve në analizimin e punimeve shkencore të autoreve vendas apo të huaj duke nxitur dialogun dhe stimuluar mendimin kritik përmes dhënies së konkluzioneve dhe rekomandimeve; e. Përfshirja e rasteve praktike të studimit gjatë orëve të seminareve të ofruara për tu përpunuar nga pedagogu apo të zgjedhura nga studenti. f. Përmirësimi i kushteve të studentëve në auditore ku ata zhvillojnë mësim përmes identifikimit të nevojave dhe përcjelljes së kërkesave buxhetore në nivel njësie bazë dhe kryesore;
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton një vullnet të qartë nga ana e UV-se në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucioni i jep këtij procesi.Vendimi i Senatit Akademik Nr.17 datë 28.03.2019 për “Planin e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit dhe mësimdhënies në Universitetin “Ismail Qemali” Vlore është një tregues i punës së vazhdueshme që institucioni kryen në drejtim të garantimit të cilësisë në programet mësimore.

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	UV organizon aktivitet sensibilizuese me studentë për pjesëmarrjen aktive të tyre në plotësimin e pyetsorit. Për këtë janë kryer edhe takime të drejtpërdrejta me studentët, publikim të njoftimeve në rrjetet promovuese të universitetit, njoftimet në adresa personale në UVMS etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: “Shkenca Kompjuterike”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Program studimi i përgatitur dhe zhvilluar në përputhje me strategjinë për zhvillimin të UV, duke synuar formimin dhe përgatitjen e profesionistëve cilësorë;
2. UV bën përpjekje në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës dhe pasurimit të bibliotekës;
3. Staf akademik dhe ndihmës akademik i përkushtuar për realizimin cilësor të programit të studimit;
4. Numri i ulët i studentëve siguron një marrëdhënie të fortë pedagog –student;
5. Vlerësim i performancës së stafit akademik dhe përfshirje e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies;
6. Sistem efektiv i menaxhimit të informacionit në shërbim të studentëve, stafit akademik dhe strukturave të UV;
7. Përdorim i teknologjisë moderne të procesin e mësimdhënies (smart board, projektorë) si dhe një bazë laboratorike në përmirësim të vazhdueshëm;
8. Marrëdhënie të institucionalizuara me universitete të huaja homologe në shërbim të kualifimit dhe shkëmbimit të eksperiencave;
9. Procedura të konsoliduara pranimi, transferimi dhe diplomimi për studentët;

b. Pika të dobta:

1. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”, në versionin aktual të tij, paraqitet me specifika të pasqyruara vetëm në rreth 10% ndryshim në raport me programin e studimit Bachelor në “Informatikë”;

2. Mungesa e praktikës mësimore si aktivitet formues i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”;
3. Mungesa e një studimi të tregut të punës të përditësuar dhe të detajuar;
4. Ngarkesë mësimore relativisht e lartë për një pjesë të personelit akademik efektiv, duke vështirësuar angazhimin efikas në kërkimin shkencor;
5. Provimet nuk zhvillohen në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim;

Rekomandime:

1. Rishikimi i planit mësimor për të ndërtuar një profil më të qartë e të dallueshëm në raport me programin e studimit Bachelor në “Informatikë”;
2. Integrimi në program i praktikës mësimore si një aktivitet i nevojshëm jo vetëm në kuadër të formimit në fushën e shkencave kompjuterike, por edhe si një mundësi për të krijuar lidhje me biznesin të cilat do të kontribonin në punësimin e ardhshëm të studentit të diplomuar;
3. Megjithëse kriteret minimale ligjore plotësohen, rekomandohet të ndërmerren hapa për përmirësimin e shkallës së kualifikimit të personelit akademik efektiv, gjë e cila do të kontribonte për ngritjen në një shkallë më të lartë edhe të kërkimit shkencor;
4. Të garantohet zhvillimi i provimeve në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim;
5. Rekrutimi i personelit akademik suplementar me qëllim reduktimin e ngarkesës mësimore;
6. Shtimi i numrit të studentëve që diplomohen me temë diplome nëpërmjet uljes së pragut të mesatares;
7. Forcimi i punës së Sektorit të Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore – Sportive në drejtim të mbledhjes së informacionit dhe gjurmimit të studentëve të punësuar;

Conclusions from the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in "Computer Science"

a. Strengths and affirmation:

1. The study programme is compiled and developed in compliance with strategy for development of UV aiming at education and preparation of qualitative graduated students;
2. The UV makes effort addressed to infrastructure improvement and enrichment of library;
3. The academic and supporting staff are committed in quality development of study programme;
4. Low number of students ensures a strong relationship/communication pedagogue-student;
5. The performance evaluation of academic staff and the inclusion of students in the periodic assessment of teaching forms and methods;
6. Effective management of information system in support of students, academic staff and structures of UV;
7. The use of contemporary technology in teaching process (smart board, projectors) as well as continuous improvement of laboratories;
8. Institutionalized partnership with international counterpart universities aiming in qualification and exchange of experience;
9. Consolidated/appropriate procedures for student admission, transfer and graduation;

b. Weak points:

1. The current version of teaching plan/curriculum in the study programme Bachelor in "Computer Science" presents in its content solely 10% specific changes with Bachelor study programme in "Informatics";
2. Lack of internship as formation activity of the study programme Bachelor in "Computer Science";
3. Lack of an updated and detailed labour market study;
4. Comparatively high teaching load for a part of full time academic staff by impeding their effective engagement in scientific research;
5. Exams are not conducted anonymously by secretion or codification;

Recommendations:

1. Reviewing the curriculum to build a more coherent and distinct profile in comparison to the Bachelor study program in "Informatics";
2. The integration of teaching practice/internship in the program shall be considered as an essential activity not only within the frame of students training in the field of computer science, but also as an opportunity to set up partnership with business which would contribute to the future employment of the graduate student;
3. Even though the minimum legal criteria are met, it is recommended to undertake action toward the improvement the qualification level of effective academic staff, thus would contribute to rise up the level of scientific research;
4. To guarantee the conduct of exams anonymously by secretion or codification;
5. The recruitment of supplementary academic staff in order to reduce the teaching load;
6. Increasing the number of graduated students with a diploma thesis through lowering the average grade criteria;
7. Enhancing the work of the Career Counselling Sector, Alumni and Cultural - Sports Activities toward gathering information and tracking the employed students;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nganjëzërisht	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË			X	

CIKLIT TË PARË BACHELOR				
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X